



USHTRIA



Viti i 78-të i botimit Nr. 48 (827953)

Botim Qendror i Ministrisë së Mbrojtjes

E premte, 5 dhjetor 2025



113 VITE NDER, BESË DHE ATDHE Lavdi Ushtrisë Shqiptare në përvjetorin e saj të shenjtë!



USHTRIA SHQIPTARE: 113 VJET PËRKUSHTIM DHE MBROJTJE

Me rastin e 113-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare, në mjediset e Muzeut të Forcave të Armatosura u zhvillua një ceremoni solemne, ku morën pjesë personalitete të larta të institucioneve të mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm...



faqe 2



TRADITË, SAKRIFICË DHE VIZION, 113-VJETORI I USHTRISË SHQIPTARE

Të nderuar anëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, sot nderojmë 113-vjetorin e Krijimit të Ushtrisë Shqiptare, një ditë që lidh historinë me detyrën dhe detyrën me të ardhmen. Kjo është një ditë reflektimi, mirënjohjeje dhe angazhimi të ri ndaj misionit tonë kushtetues: mbrojtjes së sovranitetit dhe sigurisë së qytetarëve tanë. Më 4 dhjetor 1912...



faqe 2



UNIFORMA DHE ZEMRA: HISTORIA E PËRKUSHTIMIT SHQIPTAR

4 DHJETORI – DITA E FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË

Ushtria që lindi bashkë me shtetin. Dashuria, sakrifica dhe historia që vazhdojnë të marshojnë. Ka data që nuk i përkasin vetëm kalendarit, i përkasin zemrës së një kombi. 4 dhjetori është një prej tyre. Është një ditë e cila nuk lexohet me sy, por me ndjenjë. Një ditë ku historia na bën krenarë...



faqe 6



Ministri Vengu: Anëtarësimi i Kosovës në A-5, një nevojë strategjike për sigurinë rajonale

Ministri i Mbrojtjes, Pirro Vengu, mori pjesë në Ministerialin e SHBA - Karta e Adriatikut (A-5), i mbajtur në Sarajevë, një forum i rëndësishëm që bashkon Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe pesë vende të Ballkanit Perëndimor në kuadër të bashkëpunimit rajonal të sigurisë dhe mbrojtjes.

Gjatë fjalës së tij pas përfundimit të punimeve të ministerialit, ministri Vengu theksoi se Ballkani Perëndimor vijon të përballlet me sfida të trashëguara dhe kërcënime të reja, të cilat kërkojnë qasje të koordinuar dhe investime të përbashkëta. "Ballkani Perëndimor ka ende shumë sfida të trashëguara dhe kërcënime të reja, të cilat kërkojnë partneritet më të ngushtë, investime në kapitalin njerëzor, në mbrojtje kibernetike, në industri, në pajisje dhe sisteme të përbashkëta", - deklaroi ministri Vengu.

Ai shtoi se, në bashkëpunim me SHBA-në, Shqipëria

beson fort në rëndësinë e kësaj nisme rajonale, e cila duhet të orientohet drejt bashkëpunimit më efektiv në funksion të rritjes së qëndrueshmërisë së çdo vendi anëtar.

Në këtë kontekst, ministri Vengu nënvizoi se anëtarësimi i Kosovës në A-5 përbën një nevojë strategjike, duke e konsideruar përfshirjen e saj si një hap të domosdoshëm drejt forcimit të stabilitetit rajonal.

Ministri i Mbrojtjes i Shqipërisë rikonfirmoi gjithashtu gatishmërinë e plotë të vendit tonë për të kontribuar aktivisht në kuadër të të gjitha aktiviteteve dhe

objektivave të Kartës së Adriatikut.

Rreth A-5

Iniciativa SHBA - Karta e Adriatikut (A-5) u themelua në vitin 2003 nga SHBA-ja, Shqipëria, Kroacia dhe Maqedonia e Veriut, me qëllimin kryesor mbështetjen e vendeve të rajonit në procesin e integritetit euroatlantik dhe forcimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes.

Më 4 dhjetor 2008, iniciativës iu bashkuan edhe Mali i Zi dhe Bosnje-Hercegovina, duke zgjeruar kështu bashkëpunimin rajonal në këtë platformë të rëndësishme sigurie.

Gjenerallejtënant Arben Kingji merr pjesë në Takimin e 13-të të Konferencës së Shefave të Shtabit të Përgjithshëm të nismës "DECI" në Budapest

Budapest, Hungari – Shefi i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë (FARSH), gjenerallejtënant Arben Kingji, mori pjesë në Takimin e 13-të të Konferencës së Shefave të Shtabit të vendeve pjesëmarrëse në nismën "DECI" (Defense Cooperation Initiative). Konferenca u zhvillua në Budapest, nën drejtimin e gjeneral Gabor Borondi, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Hungarisë, dhe gjeneral Luciano Portolano, shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura të Italisë.

Punimet e konferencës u fokusuan në analizën e dinamikave të reja të sigurisë rajonale dhe globale, të cilat karakterizohen nga sfida të ndërlikuara, kërcënime hibride dhe rreziqe në rritje. Diskutimet synuan forcimin e bashkëpunimit, identifikimin e zgjidhjeve të përbashkëta dhe përmirësimin e mekanizmave të reagimit, për të shmangur që sfidat e sotme të kthehen në kërcënime të nesërme. Në fjalën e tij, gjenerallejtënant Kingji theksoi se nisma "DECI" mbetet një platformë thelbësore për shkëmbimin e ideve, praktikave më të mira dhe forcimin e bashkëpunimit mes vendeve pjesëmarrëse. Ai shprehu mirënjohjen për përfaqësuesit e Gardave Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës për angazhimin e tyre afatgjatë në mbështetje të kësaj nisme.

"Shqipëria mbetet plotësisht e angazhuar në rritjen e bashkëpunimit, qëndrueshmërisë dhe prosperitetit rajonal. Ne jemi të vendosur të mbështesim çdo



nismë që forcon sigurinë kolektive dhe aftësinë për menaxhimin e krizave, si me vendet aleate të NATO-s, ashtu edhe me partnerët tanë rajonalë", - u



shpreh gjenerallejtënant Kingji, duke theksuar gjithashtu se Shqipëria po vijon me vendosmëri përmbushjen e objektivave të integritetit në Bashkimin Europian.

Gjatë punimeve u nënvizua rëndësia e vazhdimin e angazhimeve në kuadër të nismës "DECI", e cila synon rritjen e ndërveprueshmërisë, bashkëpunimit dhe forcimin e sigurisë së përbashkët ndërmjet vendeve pjesëmarrëse. Gjenerallejtënant Kingji falënderoi në mënyrë të posaçme shefin e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave

të Armatosura të Italisë, gjeneral Portolano, si dhe shtetin italian, për rolin udhëheqës dhe mbështetës në avancimin e objektivave të kësaj nisme.

Në përfundim të takimit, shefat e Shtabeve të Forcave të Armatosura të Italisë, Hungarisë, Kroacisë, Maqedonisë së Veriut, Malit të Zi, Sllovenisë dhe Austrisë nënshkruan "Deklaratën e Përbashkët", duke rikonfirmuar angazhimin e tyre për forcimin e bashkëpunimit dhe sigurisë rajonale në kuadër të nismës "DECI".

Shqipëria, pritëse e konferencës së ardhshme

U bë e ditur se vitin e ardhshëm Shqipëria do të presë Konferencën e Shefave të Shtabeve të vendeve pjesëmarrëse të nismës "DECI", një forum shumëpalësh i rëndësishëm për forcimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe ndërveprimit ushtarak mes vendeve aleate dhe partnere.

Ushtria Shqiptare: 113 Vjet Përkushtim dhe Mbrojtje

Me rastin e 113-vjetorit të krijimit të Ushtrisë Shqiptare, në mjediset e Muzeut të Forcave të Armatosura u zhvillua një ceremoni solemne, ku morën pjesë personalitete të larta të institucioneve të mbrojtjes dhe të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në këtë aktivitet morën pjesë ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, si dhe titullarë të tjerë të Ministrisë së Mbrojtjes dhe Komandantë të Forcave të Armatosura. Ceremonia pati një atmosferë solemne dhe reflektive, duke kujtuar historinë e pasur dhe sakrificat e brezave që kanë shërbyer për mbrojtjen e Atdheut. Gjatë fjalës së tij, ministri i Mbrojtjes, z. Pirro Vengu, theksoi lidhjen e pandashme midis fatit të Shqipërisë dhe forcës së Forcave të Armatosura: "Fati i Shqipërisë dhe fati i Forcave të Armatosura janë të lidhur; në vitin



1912, Ushtria ishte një domosdoshmëri për të mbijetuar. Sot, ajo është një domosdoshmëri për të ecur përpara". Ministri Vengu theksoi gjithashtu se, 16 vite pas anëtarësimit në NATO, siguria e vendit nuk bazohet te madhësia, por te përkushtimi dhe profesionalizmi i njerëzve në uniformë. Ai nënvizoi se kjo është edhe arsyeja pse aleatët ndërkombëtarë i besojnë Forcave të Armatosura të Shqipërisë. Sipas ministrit, Ushtria nuk është vetëm një institucion: "Janë njerëzit e uniformës, familjet e tyre, komunitetet që mbështeten në emergjencë, dhe qytetarët që punojnë të qetë, sepse e dinë se vendi i tyre është i mbrojtur". Ceremonia u mbyll me një përkujtim solemn të 113 viteve historike të Ushtrisë Shqiptare, duke nënvizuar se çdo ditë ndërtohet e ardhmja, duke ndjekur të njëjtin parim si në vitin 1912: Shqipëria duhet të jetë gjithmonë në gjendje të mbrohet për të qenë në gjendje të zhvillohet.



Traditë, Sakrificë dhe Vizion, 113-Vjetori i Ushtrisë Shqiptare

FJALA E SHEFIT TË SHTABIT TË PËRGJITHSHËM TË FORCAVE TË ARMATOSURA, GJENERALLEJTËNANT ARBEN KINGJI, ME RASTIN E 113-VJETORIT TË KRIJIMIT TË USHTRISË SHQIPTARE

Të nderuar anëtarë të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë,

Sot nderojmë 113-vjetorin e Krijimit të Ushtrisë Shqiptare, një ditë që lidh historinë me detyrën dhe detyrën me të ardhmen. Kjo është një ditë reflektimi, mirënjohjeje dhe angazhimi të ri ndaj misionit tonë kushtetues: mbrojtjes së sovranitetit dhe sigurisë së qytetarëve tanë.

Më 4 dhjetor 1912, vetëm gjashtë ditë pas Shpalljes së Pavarësisë, elita politike dhe ushtarake ndërmorën një vendim thelbësor: krijimin e Ushtrisë Kombëtare. Ky akt nuk ishte thjesht formalitet, por themeli i mbrojtjes dhe sigurisë së shtetit të ri shqiptar dhe një hap vendimtar drejt ndërtimit të institucioneve moderne të shtetit.

Si Shef i Shtabit të Përgjithshëm, përulëm me mirënjohje për kontributin e 26 pararendësve të mi, nga Shtatmadhuria e Ali Shefqet Shkupit e deri te shefat e mëvonshëm të Shtabit të Përgjithshëm. Secili prej tyre, në rrethana të ndryshme historike, ka mbajtur mbi shpatulla detyrën e rëndë dhe fisnike për ta reformuar, modernizuar dhe mbajtur të qëndrueshme ushtrinë tonë.

Gjatë 113 viteve të ekzistencës së saj, ushtria shqiptare ka kaluar periudha lufte, pushtimi, rezistence, tranzicioni dhe reformimi. Sot, 81 vite pas çlirimit të vendit dhe 16 vite pas anëtarësimit në NATO, Shqipëria gëzon mbështetjen e sigurisë kolektive të Aleancës së Atlantikut të Veriut dhe një pozicion të respektuar në familjen euroatlantike.

Në këtë ditë, përkulem me respekt të thellë para Dëshmorëve të Atdheut dhe të gjithë atyre që, brez pas brezi, i kanë shërbyer Shqipërisë me përkushtim dhe sakrificë. Amaneti i tyre është busulla jonë morale, e cila udhëheq çdo brez të ri që sot stërvitet, mëson dhe shërben në garnizonet e vendit.

Sfida të reja, përgjigje të përbashkëta

Mjedisi i sotëm i sigurisë është i brishtë dhe i paparashikueshëm. Lufta në kufijtë lindorë të Aleancës, tensionet etnike në Ballkanin Perëndimor, sulmet kibernetike, dezinformimi dhe taktikat hibride synojnë të godasin kohezionin tonë shoqëror dhe infrastrukturën kritike.

Në këtë realitet, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë janë pjesë aktive e arkitekturës së sigurisë euroatlantike. Ne kontribuojmë krah për krah me aleatët në misionet e NATO-s, BE-së dhe OKB-së, nga Ballkani në Lindjen e Mesme dhe nga Baltiku në detin Egje. Kudo ku shërbejnë ushtarakët tanë, ata mbajnë me nder flamurin kuqezë dhe përfaqësojnë vlerat më të mira të Shqipërisë.

Brenda vendit, Forcat e Armatosura shërbejnë në vijën e parë të emergjencave civile: përmbajtje, zjarre, tërmete, kriza humanitare dhe mbrojtje të infrastrukturës kritike. Në momentet më të vështira, misioni ynë është i qartë: të jemi të parët që mbërrijmë



dhe të fundit që largohemi.

Përforsimi i kapaciteteve dhe modernizimi

Krahas trupës aktive, po finalizojmë një model të integruar të forcave rezervë, me role të qarta, trajnime periodike dhe detyra konkrete në mbështetje të forcave kryesore dhe strukturave të mbrojtjes civile. Krenohemi edhe me rritjen e rolit të grave në uniformë, të cilat shërbejnë me profesionalizëm nga njësitë bazë deri në pozicionet strategjike të planifikimit dhe drejtimit ushtarak.

Fuqia e Forcave të Armatosura nuk matet vetëm me pajisje apo numra, por me ndërthurjen e kapaciteteve morale, konceptuale dhe fizike me karakterin, etikën, stërvitjen, doktrinën, gatishmërinë, infrastrukturën dhe disiplinën e personelit tonë.

Arritjet dhe mbështetja e aleatëve

Gjatë viteve të fundit kemi ndërmarrë hapa të rëndësishëm:

- reformim të strukturave të komandim-kontrollit;
- forcim të mbrojtjes kibernetike;
- përmirësim të programeve arsimore dhe stërvitore;
- modernizim të trupave me pajisje bashkëkohore;
- rritje të pjesëmarrjes në misione dhe stërvitje ndërkombëtare;
- përmirësim të trajtimit financiar dhe social të ushtarakut;
- rritje të interesit të brezit të ri për t'u bashkuar me FA. Falë bashkëpunimit me aleatët tanë strategjikë,

zhvillojmë programe të përbashkëta stërvitore, modernizojmë pajisjet, rrisim motivimin e personelit dhe forcojmë ndërveprueshmërinë tonë me vendet e NATO-s.

Faleminderit për disiplinën, përkushtimin dhe profesionalizmin që tregoni çdo ditë. Një falënderim i posaçëm shkon për familjet tuaja, pa mbështetjen e të cilave misioni ynë do të ishte shumë më i vështirë.

Vizioni: Një forcë më moderne, më e përgatitur dhe më e mirë trajtuar

Vizioni ynë për të ardhmen është i qartë: Ngritja e një force moderne, të mirë pajisur dhe me personel të trajtuar në mënyrë dinjitoze. Për realizimin e këtij vizioni jemi në proces të: finalizimit të ndryshimeve në Statusin e Ushtarakut; integritet të programeve të reja akademike në sistemin arsimor ushtarak; forcimit të trajnimeve dhe kualifikimeve; rigjallërimit të industrisë së mbrojtjes, nga armatimet e lehta e municionet te dronët dhe mjetet patrulluese; përmbushjes së objektivave të Aleancës për aftësi të mbrojtjes dhe gatishmëri të lartë.

Fokusi ynë mbetet: rritja e disiplinës, forcimi i stërvitjes, garantimi i gatishmërisë operacionale dhe mbrojtja e interesit kombëtar.

Ushtria shqiptare është ura që lidh historinë me të ardhmen e sigurisë sonë kombëtare. Le ta çojmë përpara këtë mision të shenjtë me integritet, profesionalizëm dhe unitet.

Gëzuar 113-vjetorin e Krijimit të Ushtrisë Shqiptare!

113-vjetori i Krijimit të Forcave të Armatosura

Ministria e Mbrojtjes zhvillon ceremoni solemne në nder të ushtrisë shqiptare

Në auditorin e Ministrisë së Mbrojtjes u zhvillua një aktivitet solem me rastin e 113-vjetorit të Krijimit të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në ceremoninë festive morën pjesë shefi i Shtabit të Përgjithshëm të FARSH, gjenerallejtënant Arben Kingji, komandantët e forcave, drejtorë drejtorish në Shtabin e Përgjithshëm, pedagogë të Akademisë së Forcave të Armatosura dhe të Kolegjit të Mbrojtjes dhe Sigurisë, kursantë, studentë, ish-ushtarakë dhe veteranë.

Të pranishmit u përshëndetën nga shefi i Shtabit të Përgjithshëm, gjenerallejtënant Arben Kingji, i cili vlerësoi rrugëtimin historik të Forcave të Armatosura, rolin e tyre themelor në mbrojtjen e vendit, si dhe kontributin e çmuar në operacionet ndërkombëtare dhe në përballimin e emergjencave civile.

Ai theksoi se përkushtimi dhe sakrifica e brezave të ushtarakëve përbëjnë bazën mbi të cilën ushtria shqiptare vijon të ndërtojë standarde moderne dhe europiane.

Gjenerallejtënant Kingji nënvizoi se fokusi kryesor mbetet forcimi i disiplinës, zhvillimi i mëtejshëm i stërvitjes së trupës, rritja e ndërveprueshmërisë dhe zgjerimi i bashkëpunimit me partnerët strategjikë, rajonalë dhe euroatlantikë, për të garantuar gatishmëri të plotë operacionale.

Kumtesat shkencore: Rikthim në rrënjët historike të ushtrisë shqiptare

Pas fjalës së tij, aktiviteti vijoi me një sërë kumtesash shkencore nga studiues të njohur të fushës së historisë dhe sigurisë kombëtare.

• Prof. asoc. dr. Bernard Zotaj prezantoi kumtesën: “Krijimi i Ministrisë së Luftës në qeverinë e Ismail Qemalit”, duke sjellë në vëmendje bazat historike të organizimit të strukturave të para ushtarake të shtetit shqiptar.

• Prof. asoc. dr. Maringlen Kasmir, në kumtesën: “Nga kriza osmane të lindja e shtetit shqiptar: Analiza e rrugëtimit drejt shpalljes së pavarësisë dhe organizimit të qeverisë së parë”, analizoi zhvillimet politike dhe gjeostrategjike që çuan në konsolidimin e shtetit shqiptar.



• Prof. asoc. dr. Etleva Smaçi paraqiti kumtesën me temë: “Forcat e Armatosura – Dimensi kryesor i sigurisë kombëtare në shtetformim”, duke theksuar rolin thelbësor të ushtrisë në arkitekturën e sigurisë së vendit.

Vlera, traditë dhe vizion drejt së ardhmes

Ky aktivitet festiv jo vetëm rikujtoi fillesat historike të Forcave të Armatosura dhe rrugëtimin e tyre mbi një shekullor, por edhe nënvizoi rëndësinë e studimit akademik, reflektimit dhe forcimit të vazhdueshëm

institucional.

Trashëgimia 113-vjeçare e shërbimit ndaj atdheut është një burim frymëzimi dhe përgjegjësie për misionin e sotëm dhe të ardhshëm të FA-ve, të cilët vijojnë të kontribuojnë me profesionalizëm në sigurinë kombëtare, mbrojtjen e integritetit territorial dhe shërbimin ndaj qytetarëve.

Me standarde moderne, përkushtim dhe vizion të qartë, Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë vazhdojnë të ecin drejt së ardhmes, duke mbrojtur vlerat dhe interesat kombëtare të vendit.



NATO zhvillon stërvitjen “Stone Wall 25” në Bullgari, Shqipëria vlerësohet për profesionalizmin e trupave të saj

Stërvitja e përbashkët shumëkombëshe e NATO-s “Stone Wall 25” u zhvillua në Bullgari, duke bashkuar në ndërveprim njësitë ushtarake të tetë vendeve të Aleancës. Qëllimi i kësaj stërvitjeje madhore ishte forcimi i bashkëpunimit, rritja e gatishmërisë dhe përmirësimi i mbrojtjes kolektive në të gjithë krahun lindor të Aleancës.

“Stone Wall 25” përbën një mundësi të rëndësishme për të konsoliduar integritimin shumëkombësh të njësive ushtarake pjesëmarrëse, si dhe për të rritur aftësitë operacionale të forcave të NATO-s, në kuadër të sfidave të sigurisë rajonale.

Në Ditën e Vizitorëve të Shquar (DVD), ndër të ftuarit ishte edhe Gjeneralmajor Ilir Xhebehxia, komandant i Forcës Tokësore të Shqipërisë. Ai u mirëprit nga drejtuesit e stërvitjes, si dhe nga pjesëtarët e kontingjentit shqiptar të dislokuar në Bullgari.

Kolonel Mattia Scirocco, komandant i njësisë shumëkombëshe, shprehu mirënjohjen dhe vlerësimin e lartë për performancën e trupave shqiptare, të cilët, siç u theksua, kanë kryer me përkushtim dhe profesionalizëm të gjitha detyrat e ngarkuara, duke u rreshtuar krah për krah me Aleatët dhe duke dëshmuar seriozitetin e angazhimit të Shqipërisë në NATO.

Stërvitja “Stone Wall 25” konsiderohet një shembull i qartë i bashkëpunimit të ngushtë dhe të suksesshëm ndërmjet vendeve aleate, si dhe një investim i rëndësishëm në forcimin e sigurisë kolektive.



Kompania EOD e Batalionit të Xhenios pastron territorin nga municionet e rrezikshme në Korçë, Pogradec dhe Maliq

Kompania EOD e Batalionit të Xhenios ka përfunduar me sukses një sërë operacionesh për pastrimin e territorit nga municionet e rrezikshme në bashkitë Korçë, Pogradec dhe Maliq. Këto operacione janë zhvilluar në kuadër të garantimit të sigurisë publike dhe parandalimit të incidenteve që lidhen me municionet e mbetura nga periudha të ndryshme.

Gjatë punës së tyre në terren, operatorët EOD kanë kryer kontrole të detajuara të sipërfaqeve tokësore, duke identifikuar dhe vlerësuar municione të ndryshme. Municionet e klasifikuara si të lëvizshme janë mbledhur dhe transportuar për trajtim, ndërsa ato me rrezikshmëri të lartë janë neutralizuar dhe asgjësuar në vend, duke eliminuar çdo kërcënim të mundshëm për banorët e zonës.

Kompania EOD vijon të jetë një prej strukturave më të rëndësishme në garantimin e sigurisë së jetës dhe pronës së popullatës civile, duke dhënë një kontribut të çmuar në mbrojtjen e komunitetit.

Motoja e tyre mbetet një kujtesë e qartë e sakrificës:

“EOD, të parët në rrezik, të fundit në lavdi”



58-Vjetori i Bazës Ajrore të Farkës, Historia, Sakrifika dhe Krenaria e Fluturimit Shqiptar

Bazës Ajrore të Farkës i përket një vend i veçantë në zemrën e çdo shqiptari. 58 vite më parë, në këtë datë të shënuar, filloi historia e një institucioni që jo vetëm ka shërbyer si mburojë e vendit, por edhe si dorë ndihme për komunitetin në kohë emergjence. Çdo helikopter, çdo fluturim dhe çdo pilot që ka shkelur këtë bazë ka lënë një gjurmë të paharrueshme.

Zanafilla, ëndrra e parë në vitin 1956

Historia e Bazës Ajrore të Farkës nuk fillon me datën zyrtare të krijimit, më 6 dhjetor 1967, por në vitin 1956. Në atë kohë, pilotë dhe teknikë shqiptarë u dërguan për trajnim në ish-Bashkimin Sovjetik, duke u përgatitur për të sjellë tek vendi aftësi të reja dhe dije të avancuara në aviacion. Ishte një hap i guximshëm, një hap që do të shënonte fillimin e profesionalizimit të forcave ajrore shqiptare.

Në vitin 1957, u krijua Njësia e Parë e Transportit Ushtarak nr. 5818, e cila përfshinte një helikopter MI-4, tre MI-1 dhe aeroplanët JAK-11, JAK-18 dhe PO-2. Komandant i njësisë u emërua Peço Polena, komandant i trios së parë të MI-4 Petrit Malindi, komandant i treshes së dytë të MI-1 Mersin Minxha, dhe komandant i avionëve JAK-18 Refit Jazo.

Më 4 shtator 1957, erdhi fluturimi i parë historik, helikopteri i pilotuar nga Peço Polena fluturoi në segmentin Tiranë-Shkodër-Tiranë. Ishte një moment i paharrueshëm, kur një ëndërr e brezave shqiptarë filloi të merrte formë në qiellin e vendit tonë.

6 Dhjetor 1967, lind Regjimenti i Parë Helikopter

Në vitin 1967, përfshirja e rreth 30 helikopterëve të rinj MI-4, të prodhuar në Kinë, shënoi një epokë të re. Regjimenti i Parë Helikopter, i krijuar më 6 dhjetor 1967, me komandant Lulo Musaj, u bë krah i fuqishëm i Forcave Ajrore. Struktura e tij përfshinte tre skuadrone helikopterësh MI-4, makineri për riparimin e helikopterëve, pista heliporti për ngritje dhe ulje të njëkohshme, kazermat dhe gjithë infrastrukturën e nevojshme për operacionet.

Ky moment simbolizon vendosmërinë dhe vizionin e shqiptarëve për të pasur një forcë ajrore të aftë, profesionale dhe të gatshme për çdo sfidë.

Baza, një qendër jetike për komunitetin dhe emergjencat civile

Baza Ajrore e Farkës nuk ka shërbyer vetëm si qendër ushtarake. Ajo ka qenë gjithmonë pranë qytetarëve në kohë krizash:

- Në rastet e përmbytjeve, ku helikopterët transportuan banorët e bllokuar dhe ndihmën humanitare.
- Në zonat malore të bllokuara nga bora, ku pilotët dhe teknikët shpëtuan jetë njerëzish të izoluar.
- Gjatë tërmeteve, duke dërguar ndihma dhe evakuuar të dëmtuarit.
- Në operacione kundër zjarreve dhe shpërndarje ndihmash, duke ofruar një dorë të fuqishme ndihme për komunitetin.

Çdo vit, baza kryen mbi 500 fluturime humanitare, duke treguar se forcat ajrore shqiptare janë jo vetëm mbrojtëse të vendit, por edhe një dorë shpëtimi dhe solidariteti.

Stërvitja dhe profesionalizmi, standardet e larta të fluturimit

Personeli i bazës është trajnuar intensivisht për të përmbushur çdo



detyrë. Transportimi i trupave, operacionet SAR, shpërndarja e ndihmave ushqimore dhe transporti i pacientëve janë vetëm disa nga misionet që realizohen çdo ditë. Trajnime të përbashkëta me ushtritë e huaja kanë rritur nivelin profesional dhe kanë forcuar bashkëpunimin ndërkombëtar.

Shumë pilotë dhe teknikë janë kualifikuar në Itali, SHBA, Turqi, Greqi, Gjermani, Francë dhe Mbretëri e Bashkuar, duke e bërë bazën një pikë referimi të profesionalizmit.

Drejtuesit dhe personalitetet që bënë historinë

Baza Ajrore e Farkës ka pasur drejtues të shquar: Lulo Musaj, Refat Kasimati, Hetem Mehmeti, Sinan Çela, Enver Taho, Beqir Barxha, Raqi Qarri, Syrja Gjoka dhe Frederik Beltoja. Çdo komandant ka kontribuar në zhvillimin, modernizimin dhe profesionalizimin e bazës, duke lënë një trashëgimi që vazhdon edhe sot.

Modernizimi nga "MI-4" tek "Black Hawk"

Në vitet e fundit, infrastruktura e bazës është modernizuar ndjeshëm, kazermat, makineritë për mirëmbajtje dhe kulla e fluturimit me vegla moderne, e kanë bërë bazën të gatshme për fluturime ditore dhe nate.

Helikopterët "Black Hawk" e kanë ngritur nivelin e kapaciteteve operacionale, duke e bërë Bazën Ajrore të Farkës një qendër të rëndësishme edhe për misionet ndërkombëtare.

Trashëgimia dhe brezat e rinj

58-vjetori i bazës është një rast për të nderuar sakrificat dhe guximin e brezave të mëparshëm, të cilët shpesh sakrifikonin edhe jetën për të përmbushur misionet. Trashëgimia e tyre vazhdon tek brezat e rinj, të cilët marrin pjesë me përkushtim në emergjencat civile, stërvitje të përbashkëta brenda dhe jashtë vendit, dhe në misione ndërkombëtare.

Një datë për krenari dhe reflektim

6 dhjetori nuk është vetëm një datë historike; është një ditë krenarie për të gjithë ata që kanë shërbyer dhe vazhdojnë të shërbejnë në Bazën Ajrore të Farkës. Është një ditë për të kujtuar guximin, përkushtimin dhe profesionalizmin, që e kanë bërë këtë bazë simbol të fuqisë, solidaritetit dhe shërbimit ndaj komunitetit dhe vendit.

58 vjet, një histori fluturimi, një histori sakrifice, një histori krenarie shqiptare.





ANJEZA MUSOLLARI,
Shefe e Sektorit të Botimeve

4 DHJETORI – DITA E FORCAVE TË ARMATOSURA TË SHQIPËRISË

Ushtria që lindi bashkë me shtetin. Dashuria, sakrificat dhe historia që vazhdojnë të marshojnë.

Ka data që nuk i përkasin vetëm kalendarit, i përkasin zemrës së një kombi. 4 dhjetori është një prej tyre. Është një ditë e cila nuk lexohet me sy, por me ndjenjë. Një ditë ku historia na bën krenarë.

Në këtë datë u ngritën themelet e Forcave të Armatosura, krahu që ka mbrojtur Shqipërinë, flamurin, kufijtë, familjet, lirinë, dhe besën tonë të lashtë.

Dhe në këtë ditë, të gjithë ne që e duam këtë vend, ndiejmë një përgjegjësi dhe një mirënjohje të thellë.

Por unë, unë personalisht, 4 dhjetorin e shoh edhe në dimensionin njerëzor:

si bashkëshortja e një ushtaraku që ka dhënë 40 vite jetë për këtë uniformë.

Vite që kanë qenë edhe të miat, edhe të fëmijës tonë, edhe të çdo dite ku pritja, krenaria dhe sakrificat janë bërë pjesë e frymëmarrjes sonë.

LINDJA E USHTRISË SHQIPTARE

Viti 1912 ishte viti i Pavarësisë, viti i flamurit të valëvitur mbi Vlorë, ishte viti që e detyroi Shqipërinë e sapolindur të mësonte të mbrohej.

Pa ushtri, liria ishte si shtëpia pa çati, e brishtë, e pambrojtur, e rrezikuar nga çdo shi.

Më 4 dhjetor, u krijua Ministria e Luftës. Në atë zyrë të vogël shtetërore, të mbushur me pasion dhe varfëri, filloi të merrte formë ëndrra që Shqipëria do t'i qëndronte botës me dinjitet. Ata burra, të veshur thjesht, por me zemra të mëdha, themeluan një forcë që nuk kishte topa moderne, nuk kishte avionë, nuk kishte ushtri të rregullt ... kishte vetëm vullnetin për të mos u zhdukur nga harta. Dhe vullneti, shpesh, është arma më e fortë e një populli.

RRUGËTIMI QË NUK PËRFUNDON.

USHTRIA SI PASQYRË E VETË SHTETIT

Ushtria shqiptare është rritur me vuajtjet dhe fitoret e këtij kombi.

Ka pasur kohë pranverash ku të rinj të shumtë e kanë parë uniformën si ëndërr.

Ka pasur kohë dimrash ku ushtria ka mbajtur barrë më të rëndë se ç'duhej të mbante.

Ka kaluar reforma, stuhit politike, prova morale, ndryshime epokash, dhe megjithatë ka qëndruar. Sepse ushtria është institucioni ku shteti provohet në mënyrën më të sinqertë, në disiplinë, në dashurinë për atdheun, në gatishmëri.

Sot ne flasim për një ushtri të re, një ushtri moderne, një ushtri të integruar në NATO, si pjesë e familjes euroatlantike. Një ushtri që nuk është më vetëm mbrojtëse, por edhe bashkëpunuese në misionet paqeje në shumë vende të botës. Një ushtri që punon në heshtje, por rezulton me zë të fortë.

USHTARAKU SHQIPTAR, NJERIU

QË NUK PËRFUNDON KUR MBYLLET ORARI

Të jesh ushtarak, do të thotë të jetosh mes dy botëve, botës së uniformës dhe asaj familjare. Dhe në asnjërin prej tyre nuk ke pushim, sepse të dyja

UNIFORMA DHE ZEMRA: Historia e Përkushtimit Shqiptar



të kërkojnë me zemër të plotë.

Uniforma nuk është thjesht veshje. Është premtim. Është përgjegjësi e heshtur që të ndjek edhe kur je jashtë shërbimit.

Ushtarakët tanë janë njerëzit që: janë gati të nisen në çdo orë të ditës dhe natës, shkojnë në zonat e përmbytura për të shpëtuar familje, qëndrojnë në kufi kur të tjerët festojnë, stërviten në shi, në borë, në mjegull, në vapë, ruajnë qetësinë kur vendi ka nevojë për paqe. Ata nuk e pyesin veten nëse është e lehtë apo e vështirë. E dinë që është e drejtë. Dhe e bëjnë.

ZËRI IM, ZËRI I NJË BASHKËSHORTJEJE QË PRET, QË LUMTURON, QË LUTET

40 vite shërbim të bashkëshortit tim nuk janë thjesht numër. Janë kapituj jete.

Janë net të gjata pritjeje, ku telefoni dukej i rëndë sa një mal. Janë ditë festash ku karrigia e tij në tavolinë mbetej bosh.

Janë orë kur fëmija jonë pyet: "Mami, babi a vjen sot?", dhe unë duhej të gjeja buzëqeshjen që t'i jepte shpresë.

Por janë edhe mëngjese kur ai kthehej, i lodhur, me uniformën që mbante aromën e shiut, të tokës, dhe unë shihja tek ai, jo lodhjen, por nderin.

Jam rritur krah tij si grua, si nënë, si shtyllë. Jam bërë e fortë, sepse ai kishte një mision më të madh se ne të dy. Kam mësuar se dashuria e vërtetë nuk është vetëm pranë, por edhe larg, kur largësia është e domosdoshme për atdheun.

Nëse më pyesni pse jam krenare, përgjigjja është e thjeshtë:

Sepse jam bashkëshortja e një burri që i ka i ka kushtuar çdo ditë të jetës Shqipërisë.

FAMILJA E USHTARAKUT, HEROIZMI QË NUK SHKRUHET NË RAPORTE

Në çdo ushtri të botës, ekziston një shtyllë e padukshme: familja. Pa të, detyra do të peshojë shumë më rëndë. Pa të, sakrificat do të njëhej vetëm nga njëra anë.

Familja e ushtarakut është shkolla e durimit:

Të heshtjes. Të forcës së brendshme.

Të ditëve që kalojnë duke pritur derën të hapet.

Të gëzimeve që shpesh shtyhen për më vonë.

Të dhimbjeve që mbahen brenda për të mos e

ngarkuar atë që shërben.

Ne, bashkëshortet dhe fëmijët e ushtarakëve, jemi ushtarë pa uniformë.

Nuk marrim grada, nuk marrim dekorata, por mbajmë barrën e një detyre që e quajmë jetë.

USHTRIA SHQIPTARE SOT, SHPRESË, DINJITET, BESA E LASHTË

Është e lehtë të shohësh sot uniformën moderne, pajisjet bashkëkohore, stërvitjet ndërkombëtare.

Por pas tyre ka mijëra orë mendi, reforma dhe sakrificat që i kanë kthyer Forcat e Armatosura në një institucion që i bën nder Shqipërisë.

Sot, ushtarët tanë shërbejnë në misionet të NATO-s, në operacione paqeruajtëse, në katastrofa natyrore, në mbrojtjen e kufijve, në çdo nevojë madhore të shtetit.

Ata, janë ambasadorë të vendit tonë në çdo uniformë që veshin jashtë kufijve.

FALËNDERIMI QË MERITON TË THUHET ME ZË TË LARTË

Në këtë ditë të shenjtë, dua t'u them faleminderit:

Të gjithë ushtarakëve burrave dhe grave, të rinjve dhe veteranëve, të atyre që shërbejnë sot dhe të atyre që kanë shërbyer me vite.

Ju faleminderit për paqen që na jepni. Për netët pa gjumë që keni kaluar. Për rreziqet që keni marrë përsipër. Për dinjitetin që keni ruajtur.

Faleminderit edhe juve, familje të dashura! Për durimin tuaj. Për lotët e fshehur. Për buzëqeshjet e gjetura me mund. Për forcën që i jepni ushtarakut tuaj.

Pa ju, asnjë ushtri nuk do të ishte e plotë.

4 DHJETORI NUK ËSHTË VETËM HISTORI, ËSHTË PREMTIM

4 dhjetori është kujtesë e rrënjëve tona, por është edhe dritë për të ardhmen. Është garantim se Shqipëria do të ketë gjithmonë bij e bija që do ta mbrojnë. Është premtim se uniforma nuk do të zhveshet kurrë nga nderi.

Është dëshmi se kombi ynë di të sakrifikojë, di të dojë, di të qëndrojë.

Ushtria nuk është thjesht në kazermë. Ushtria është në zemrën e çdokujt që e do Shqipërinë.

Kontributi i Grave dhe Vajzave Oficere në Ushtrinë Shqiptare

Roli i grave dhe vajzave shqiptare në Luftën Antifashiste Nacionalçlirimtare (LANÇ) është i njohur, por më pak është folur për fatin e tyre pas çlirimit, sidomos për ato që synuan të vazhdonin rrugën si oficere në ushtrinë e re shqiptare.

Me këtë material historik redaksia e shtypit ushtarak, hedh dritë mbi një periudhë të rëndësishme, të kontributit femëror në Forcat e Armatosura të Shqipërisë, duke u mbështetur plotësisht te dokumentet arkivore dhe dëshmitë e kohës.

Gra dhe vajza në radhët e Ushtrisë Nacionalçlirimtare

Gjatë LANÇ-it, mijëra gra dhe vajza iu bashkuan formacioneve partizane si luftëtare të armatosura, si instruktore, komisarë rinie, përgjegjëse politike, lidhëse, mjeke, infermiere dhe në funksione të tjera drejtuese. Disa prej tyre shërbyen në shtabe brigadash, në shtabe zonash, madje edhe pranë Shtabit të Përgjithshëm të ushtrisë partizane. Kontributi i tyre shtrihej në të gjitha frontet: brenda kufijve të Shqipërisë, në trojet shqiptare jashtë kufijve administrativë të 1944-s, si dhe në operacione të përbashkëta me ushtritë aleate kundër gjermanëve.

Ky angazhim masiv, i paprecedentë për kohën, krijoi pritshmëri se vajzat dhe gratë do të kishin një rol domethënës edhe në ushtrinë e re të shtetit shqiptar.

Pengesat pas çlirimit, mentaliteti dhe politika shtetërore

Megjithëse shumë prej tyre shprehën dëshirën të vazhdonin karrierën ushtarake, realiteti ndryshoi shpejt. Vendimet politike të viteve të para pas çlirimit sollën reduktimin drastik të pranisë së grave në ushtri. Dokumenti më domethënës është fonogrami nr. 63, datë 13.11.1944, firmosur nga Koçi Xoxe, i cili urdhëronte largimin gradual të grave nga ushtria, me arsyetimin se “mund të kontribuonin më mirë në sektorë të tjerë civilë”. Ky qëndrim ishte i ndikuar edhe nga praktika e ushtrisë jugosllave të asaj kohe, me të cilën drejtuesit komunistë kishin marrëdhënie të ngushta.

U lejua vetëm një numër simbolik grash oficere pa kompetenca reale ndërsa të tjera u orientuan drejt administratës civile, arsimit, kulturës e shëndetësisë.

Kursi i parë i oficerëve (1945) - Nëntë vajza nga fronti i luftës

Më 28 mars 1945, u hap Shkolla Ushtarake “Skënderbej”, në të cilën, krahas rreth 200 kadetëve djem, morën pjesë edhe 9 vajza partizane. Ato vinin nga brigadat sulmuese ku kishin luftuar që në moshën 14-15 vjeçare. Shtatë prej tyre kryen vitin e parë mësimor; vetëm gjashtë e përfunduan të plotë dhe u titulluan oficere aktive.

Ndër to dallohen:

- Valentina Murzaku (Brigada e 23-të Sulmuese)
- Xhevrije Golemi (Brigada V Sulmuese)
- Katerina Prifti (Brigada I Sulmuese)

Dëshmia e Valentina Murzakut është një



pasqyrë e gjallë e asaj periudhe. Ajo kujton se si vajzat e reja, ende me armë mbi shpatulla, u ulën në bankat e shkollës ushtarake, plot shpresë se do të ishin bërthama e brezit të parë të oficerëve të Shqipërisë. Por pas vitit të parë, një urdhër i Ministrisë së Mbrojtjes ndaloi vazhdimin e studimeve ushtarake për femrat.

Edhe pse të diplomuara, këto oficere u dërguan në sektorë civilë, në arsim, shtyp, banka, shkencë e kulturë, ku dhanë kontribute të shquara. Rasti i Valentina Murzakut, gazetare, punonjëse në Bankën Qendrore dhe specialiste në Institutin e Shkencave, është tipik për fatin e shumë grave që nisën si luftëtare e oficere, por karrierën e përfunduan jashtë strukturave ushtarake.

Kursi i dytë i oficerëve (1949–1951)

Në vitet 1949 – 1951, Ministria e Mbrojtjes organizoi një tjetër kurs formimi për oficere, i përbërë prej rreth 10 vajzash, të cilat kishin qenë pjesëtare të LANÇ-it. Këto oficere shërbyen për disa vite në funksione



administrative dhe kulturore në ushtri, kryesisht në:

- Shkollën Ushtarake “Skënderbej”
- Shkollën e Bashkuar të Oficerëve
- Seksionet e kulturës dhe të edukimit ushtarak

Disa prej tyre ishin njëkohësisht edhe sportiste të klubit “Partizani”, pjesë e ekipit të qitjes, duke përfaqësuar ushtrinë në gara kombëtare dhe ndërkombëtare.

Figura kryesore të këtij kursi ishin:

- Vitori Kondo-Fico – Oficere e kulturës në Shkollën “Skënderbej”, më pas funksionare civile
- Naze Levendi-Dervishi – Punoi në Shkollën e Bashkuar, pastaj në sektorin e shëndetësisë
- Sofije Kristo – Funksionare në administratën e mbrojtjes
- Dhora Zenko – Veprimtare dhe specialiste në institucionet shtetërore.

Megjithëse prania e tyre ishte e kufizuar në kohë dhe numër, ato u bënë femrat që mbajtën gjallë profilin e “oficeres shqiptare” në vitet më të vështira të ndalimit formal.

Gjurmët e lëna dhe rëndësia historike

Pavarësisht pengesave të shumta politike e shoqërore, këto gra lanë një trashëgimi të vyer:

- Ato përfaqësojnë brezin e parë të oficerëve shqiptare.
- Dëshmojnë se gratë shqiptare ishin të afta, të zonja dhe të gatshme të mbanin detyra ushtarake.
- Ato krijuan modele të hershme frymëzuese për gjeneratat e mëvonshme.
- U bënë pjesë e historisë së emancipimit shoqëror të gruas pas Luftës së Dytë Botërore.

Rihapja e mundësive për vajzat, Brezi i 1967-s

Në vitin 1967, politika shtetërore ndryshoi. Mbi 70 vajza nga e gjithë Shqipëria u pranuan në Shkollën e Bashkuar të Oficerëve në Tiranë. Ky vit shënon fillimin e integritimit real të grave në Forcat e Armatosura, tashmë në rrethana më të favorshme dhe me qëllim që të përgatiste oficere karriere në funksione të ndryshme, nga artileria te komunikacionet e deri te shërbimi mjekësor ushtarak.

Ky brez trashëgoi rrugën e vështirë të atyre pak femrave që i paraprinë kohës së tyre në vitet 1945 dhe 1951. Historia e oficerëve të para shqiptare është një histori sakrifice, idealizmi dhe zhgënjimi, por edhe e një kontributi të jashtëzakonshëm që meriton të njihet dhe të vlerësohet. Ato ishin luftëtare, vajza të reja të rritura përpara kohe, që ndërtuan lirinë me armë në dorë dhe kërkuan të shërbenin njëloj si burrat në rindërtimin e atdheut.

Megjithëse rruga e tyre u ndërpre nga politika e kohës, puna, kujtimet dhe shembulli që lanë mbeten pjesë e identitetit institucional të ushtrisë shqiptare. Ato i hapën rrugën brezave të rinj të vajzave që më vonë do të bëheshin oficere, instruktore, pilote, mjeke ushtarake, komandante dhe drejtues të rëndësishëm në Forcat e Armatosura.

Ky material shërben si një homazh për kontributin e tyre dhe si një rikthim i merituar në histori.

KRIJIMI I USHTRISË KOMBËTARE SHQIPTARE NGA QEVERIA E PËRKOHËSHME E VLORËS (1912-1914)



KOLONEL (R) SALI ONUZI

Sigurimi i Kuvendit kombëtar dhe i veprimtarisë së Qeverisë, kërkonin organizimin e forcave të armatosura. Për këtë qëllim Ismail Qemali që më 26 nëntor formoi një komision organizues dhe u dërgoi pleqësive të fshatrave një qarkore, me anën e së cilës porositeshin të mobilizonin njerëzit e aftë për armë dhe t'i mbanin ata në gatishmëri. Më 4 dhjetor 1912, Kuvendi i Vlorës zgjodhi Qeverinë e Përkohëshme dhe Ismail bej Vlorën Kryeministër. Po atë ditë u zgjodh Ministër i Luftës Mehmet Pashë Dërralla. Nga struktura dhe përbërja e Ministrisë së Luftës njohim pozicionin e zëvendësministrit të Luftës, në të cilin u caktua Xhelal Koprencka dhe të disa komandantëve ushtarakë, si Isa Boletini, Hajredin bej Cakrani, Riza bej Gjakova etj. Pas formimit të saj, Qeveria dërgoi një forcë të vogël të armatosur me vullnetarë patriotë (vullnetarë kosovarë) të ruanin bregun e Vjosës. Ajo ngriti komisione të mbrojtjes kombëtare nëpër krahina dhe urdhëroi mobilizimin e batalioneve redif e mustafëz për mbrojtjen nga forcat greke që kishin ardhur deri në Himarë. Kërkesa e saj për të çarmatosur ushtarët turq në Myzeqe e për të armatosur ushtarë shqiptarë, nuk u pranua, as nga Turqia e as nga Austro-Hungaria e Italia. Në janar 1913 Qeveria kish ngritur dhe armën e Xhandarmërisë, e cila në fund të vitit numëronte 4 detashmente me nga 300 xhandarë secili. Por puna e mbrojtjes do të kishte një hap në fillim të majit 1913.

Më 5 maj 1913, (më 22 prill sipas kalendarit të vjetër) Qeveria e Përkohshme e Vlorës do të diskutonte e miratonte Rregulloren për organizimin e përkohshëm të Ministrisë së Luftës. Në përbërje të Ministrisë së Luftës do të ishte Shtati (Shtabi) Madhor. Për shkak të njohjes dhe kredibilitetit që gëzonte, Major Ali Shefqeti do të emërohej në detyrën e lartë e të nderuar të Kryetarit të këtij Shtabi Kjo ishte bërë e domosdoshme, sepse kishin kaluar 5 muaj që Ministria e Luftës (nga 4 dhjetori 1912) funksiononte pa një akt themelor normativ (me siguri në bazë urdhrash të veçantë për çështje konkrete që dilnin. Ministria e Luftës do të kishte gjithashtu edhe zyrën Qertare (të prapavijës, apo intendencës), zyrën hertare (të organizimit e personelit) dhe zyrën Shëndetare, të cilat në disa artikuj e botime janë dhënë tjetër për tjetër. Që kishte një zyrë të tillë të Intendencës në Ministrinë e Luftës e shkruan vetë Ali Shefqeti në një shkresë dërguar Ministrisë së Financave. E gjejmë edhe në një shkresë të 29 marsit 1914, për uniformat e oficerëve dhe ushtarëve drejtuar gjeneralit holandez Dever, firmosur dhe vulosur po me atë vulë, "Qarku Qertar". Në vijën e dytë të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej edhe ndërtimi i brendshëm i vetë Shtabit Madhor, i cili, nga ana e tij, përbëhej nga:



Ismail bej Qemali dhe Isa Boletini në Vlorë, 1912

- Qarqet e Shtabit Madhor (të themi drejtori, a departamente)
- Shkresina e Shtabit Madhor (Sekretari arkivi)
- Komisioni i rregulloreve
- Komisioni i trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë dhe
- Komisioni i ndërtimit (a xhenios, si të thuash)

Rregullorja në mënyrë sintetike kish fiksuar edhe detyrat e të drejtat e Shtabit. Në një 4 të Rregullores së Ministrisë së Luftës përcaktohej se "Zyra e Shtabit Madhor asht e detyrueme për me i rradhiti nomet, rregulloret dhe ushtrimoret e Armëve të ndryshme që i duhen ushtërisë dhe për me e sigurue disiplinën e ushtërisë e qetësinë e vendit". Rregullorja kërkonte që, deri sa të bëhej Organizmi themelor, Qarqet e Shtabit Madhor do të vepronin si një Komision, i cili do të studionte projektet që do t'i paraqiteshin, të cilat edhe mund t'i ndryshonte dhe, bashkë me raportin përkatës, do t'ia kalonte Qeverisë nëpërmjet Ministrisë së Luftës. Kështu vetë Shtabi Madhor vepronte në fillimet e tij si një Komision (Qark). Kjo del dhe nga vula që ai përdorte: Qarku i Shtatit Madhor (1913) në njëshkresë të firmosur nga Kryetari i Shtatmadhorisë Ali Shefqeti. Ky është padyshim një tregues i gjendjes së vështirë financiare, në mos edhe i mungesës së kuadrove përkatës, të cilët duhej të ishin të diplomuar si oficerë Shtabi. Në Vlorë ishin paraqitur e vënë në dispozicion të Qeverisë 70 oficerë dhe 150 nënoficerë shqiptarë. Shtabi Madhor do të hartonte edhe projekt-detyrat e raportet e Zyrave të tjera, të cilat ai i konsultonte me to (ndryshoheshin kur duhej), i parapëlqente (ose jo) dhe ia kalonte gjithashtu Ministrisë së Luftës. Fakti që Ministria e Luftës e shtetit të ri shqiptar u konceptua dhe u ndërtua me Shtab Madhor, që më 1913, tregon se ndërtimi i Ushtrisë së rregullt filloi nga lart poshtë, karakteristikë për një shtet ligjor,

modern. Rregullorja e përkohshme e Ministrisë së Luftës në vijën 7 të saj përcaktonte se "Do të ishin në veprim nomet (ligjet) e Turqisë deri sa të radhiteshin nomet (ligjet) dhe rregulloret e reja". Kjo ndodhi edhe në organizmin ushtarak, ku mbet në fuqi dhe u zbatua ligji për mobilizimin e redifëve (rezervistëve) dhe mustafëzve (forca vendore territoriale) që kishin qenë para shpalljes së Pavarësisë. Këto batalione u mobilizuan dhe luftuan kundër reparteve të ushtrisë greke që po përparonin në Shqipërinë e jugut. Në krye të tyre në terren ndodhej Xhelal Koprencka (firmosës i Pavarësisë) zëvendësministri i Ministrisë së Luftës. Komandantë të batalioneve me redifë (rezervistë) ose mustafëiz (territorial) ishin vetë bejlerët, të zotët e bujqve ushtarë, që veç komandimit, përgjigjeshin edhe për logjistikën dhe ndërrimin e batalioneve në front. Hajredin bej Cakrani, njëri nga firmosësit e deklaratës së Pavarësisë dhe feudal i madh nga Cakrani i Mallakastrës, që kishte mbaruar studimet e larta ushtarake në Stamboll, ai kishte qenë para 28 nëntorit dhe ishte edhe pas tij, komandant i batalionit "mustafëz" të Lushnjës, plus dhe komandant i operacionit qeveritar në front kundër grekëve. Për këto reparte dhe veprimtarinë e tyre pothuajse nuk bëhet fjalë në tekstet e historisë, por ato shkrihen e shihen thuajse të gjitha si "forca vullnetare", kur në fakt ato kishin detyrim ligjor, po se po patriotik, të shërbenin e luftonin, siç edhe bënë një pjesë e mirë e tyre, batalionet e Beratit, Mallakastrës, Skraparit, Tepelenës, Përmetit, Leskovikut e Gjirokastrës, në jug kundër pushtuesve grekë dhe në Shkodër redifët dhe mustafëzët nga Shqipëria e Mesme, (Shijaku, Tirana, Kavaja e Elbasani) dhe nga Shkodra e Dibra, kundër pushtuesve malazezë. Por në praktikë nuk shkonte gjithçka siç shkruhej. Ministri i Luftës Mehmet Pashë Dërralla, më 31 janar 1914, i

shkruante komandës së bylykut të Dukatit që të dërgonte emrat e 57 redifëve (rezervistë) që ishin nisur për të patur nën këqyrje pozitën e Llogorasë dhe, siç kish raportuar ajo vetë, ishin arratisur. Më 2 shkurt komandanti i batalionit Alem Mehmeti njoftonte se atje nuk kish mbetur asnjë redif. Edhe komandanti i batalionit mustafëz, Sadullai i shkruante, më 7 dhjetor 1912, Ministrisë së Luftës, se 200 ushtarët që pati, 100 në Delvinë e 100 në Sarandë, ishin arratisur nga mungesa e ushqimit dhe ai ishte kthyer ne Tepelenë vetëm me ordinancën e tij. Kajmekani i Vlorës Mustaf Asimi njoftonte, më 15 dhjetor 1912, se ushtria popullore që ndodhet në anë të Mesaplikut ka mungesa municioni e ushqimi, e sidomos rregulli e disipline, dhe... armiku iu bën thirrje për dorëzim. Sidoqoftë këto mangësi nuk e zhvlerësojnë punën që ishte bërë për krijimin e ushtrisë dhe veprimin e saj në terren. Përpjekjet e Qeverisë vijnë më tej. Kryetari i Shtabit Madhor Ali Shefqeti (Shkupi), më 3 qershor 1913, i përcjell për studim Ministrit të Punëve të Brendshme, Myfit bej Libohovës, variantin e parë të rregullores së Milicisë shqiptare, para se të bisedohej në Këshillin e Ministrave. Kjo Rregullore sot gjendet në Arkivin e shtetit shqiptar si një dëshmitare e punës së Shtabit madhor të atëhershëm, madje edhe është botuar e bërë publike. Edhe konsulli austro-hungarez Lejhaetz, njoftonte Vjenën se Zyra (e Shtabit Madhor) hartoi “Rregulloren mbi formimin e Milicisë shqiptare”, sipas së cilës kjo e fundit duhej të ishte një forcë e organizuar, e ngritur mbi bazën e detyrimit ushtarak të përgjithshëm dhe që kishte për detyrë mbrojtjen e vendit deri sa të krijohej një ushtri e rregullt. Më pas del Urdhri për formimin e Kompanisë Këmbësore model të ushtrisë, ku shtrohet edhe nevoja e fillimit të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Nga informacioni i konsullit Lejhanetz del se “administrata ushtarake shqiptare kishte ndërmend të bënte më parë studime mbi sistemet e ndryshme ushtarake europiane, pastaj, të vendoste ose të merrte njërin prej tyre ose të krijonte një sistem të ri, të vetin, që u përshtatej kushteve të vendit. Prandaj konsulli i përcillte Vjenës lutjen e kësaj administrate për t’i vënë sa më shpejt në dispozicion një numër librash shërbimi lidhur me organizimin, stërvitjen dhe shërbimin e brendshëm të armëve të ndryshme të ushtrisë..., si këmbësoria, kaloria, artileria, xhenioja, prapavija dhe shëndetësia . Në fakt brenda 26 ditëve nga krijimi i Shtabit, më 31 maj 1913, Kryetari i tij informonte ministrinë e Luftës, mbi punën që po bëhej për krijimin e kompanisë model të Ushtrisë, sipas të cilës do të ndërtohej Ushtria Kombëtare. Aty shtrohej edhe nevoja e fillimit së afërmi të shërbimit të detyrueshëm ushtarak. Më 4 shtator, gazeta “Dielli” në SHBA shkruante se “Qeveria mbledh ushtarë me 240 grosh në muaj, jo me pahir, po cili do vetë. ...Flitet se Guberna shqiptare do të mbledhë gjer në 20 mijë veta, të cilët do të jenë të veshur, mbathur dhe armatisur mirë, me topa, mitraloza dhe municione etj.”. Në arkivin e shtetit ruhet edhe një foto e kompanisë model të krijuar me emrat e oficerëve të tyre. Po në “Dielli”, më 31 tetor 1913, me burim nga Vlora njoftohej se “në Vlorë janë tre taborë (batalione S.O) ushtarë të Shqipërisë të veshur, të mbathur e të armatisur dhe të stërvitur mirë, me topa etj. ...Janë edhe 7 çeta shqiptare (pra vullnetare) të organizuara fare mirë, të cilat kanë me 300-500 njerëz njëra. Kryetarët e çetave janë këta: Mehmet Pavari, Nexhip Bënja, Salih Butka, Dino Çiçi Gjinokastra, Namik Delvina, kapedan Spiro Korça dhe Çerçiz Topulli”. Me detyrën e kryetarit të Shtabit Madhor, major Ali Shefqeti komunikonte me telegraf dhe transmetonte vendime të Qeverisë apo urdhra e udhëzime të Ministrisë së Luftës e të vetë Shtabit për veprime luftarake, dërgim oficerësh, armatimi e municioni në territore të ndryshme të vendit, në jug kundër forcave

pushtuese greke dhe në Dibër, ku po zhvillohej kryengritja e shtatorit të vitit 1913. Shtabi i drejtuar prej tij i kish sugjeruar Qeverisë dhe ajo kishte porositur jashtë shtetit, sidomos në Austro-Hungari, topa, mitraloza, uniforma, dhe ajo që të befason, edhe “një numër librash shërbimi dhe veprash të ndryshme që do t’i shërbenin administratës ushtarake të Qeverisë”. Që më 1913, Shtabi Madhor i pat hyrë një punë të veçantë për terminologjinë ushtarake. Për këtë çështje ai pat angazhuar një komision të posaçëm në të cilin bënë pjesë oficerë të kulturuar si Mustafa Maksuti dhe Kamber Sejдини (Dëshmor i Atdheut, nga Elbasani,) ish-profesor i frëngjishtes në gjimnazin ushtarak të Manastirit. Veprimtarisë së këtij komisioni i takojnë shumë terma që përdorim sot në fushën ushtarake. Por puna e Qeverisë së Vlorës për Ushtrinë do të vështirësohej pas Vendimit të Konferencës së Ambasadorëve të 29 korrikut 1913, i cili ndonëse njihte shtetin shqiptar, (nën garancinë e Fuqive të Mëdha) e vinte atë nën kontrollin e një Komisioni Ndërkombëtar që ngarkohej për organizimin e gjithë degëve të administratës civile (por jo dhe asaj ushtarake) ashtu siç caktoi oficerë të huaj për organizmin vetëm të xhandarmërisë. Efektet negative të mungesës së organizimit ushtarak do të ndjeheshin fort në ngjarjet tronditëse e tragjike të vitit 1914, ndërkohë që garancia e Fuqive të Mëdha u shkri si kripa në ujë. Historiografia zyrtare shqiptare nuk e ka evidentuar dhe vlerësuar sa duhet veprimtarinë ushtarake të Qeverisë së Vlorës. Prof. Arben Puto në “Pavarësia shqiptare dhe diplomacia e fuqive të mëdha 1912-1914”, i referohet vetëm konsullit Lejhanetz për një “zyrë të shtatmadhorisë”, që me nënvleftësim e quante njëloj organi ushtarak i Qeverisë së përkohshme. kur ai ishte një organ i vërtetë ushtarak. Për më keq teksti i Akademisë ushtarake i vitit 1986 as nuk e përmend këtë “Zyrë shtatmadhorie”. Prof. Arben Puto, konkludon se Qeveria e Vlorës mori disa masa organizative paraprake, por nuk arriti asnjëherë të krijonte as dhe bërthamën e një ushtrie kombëtare. Ndërsa teksti akademik i Historisë, i vitit 2002 ripërsërit konsullin austriak dhe e quan krijimin e një ushtrie të rregullt një “objektiv i parakohshëm”, i perealizueshëm në ato rrethana. Po këtë shkruan edhe “Historia e popullit shqiptar gjatë shekullit të XX”. Ky mendim për administratën ushtarake nuk na duket bindës dhe mendojmë se duhet hetuar e diskutuar më tej. Në kujtimet e tij Ismail Qemali shkruan se:

“Si u ktheva (nga Londra, S.O) në Vlorë, në qershor 1913, Qeveria e përkohshme i dyfishoi përpjekjet për organizmin e vendit dhe për ruajtjen e rendit. Mund të ishin quajtur fare mirë detyra të pamundshme për t’u kryer, por punën e bënte më të lehtë karakteri i shqiptarit-durimin, maturinë dhe patriotizmin e paepur të të cilit, mes gjithë atyre ngatërresave e halleve, nuk ka fjalë e lëvdatë që ta përshkruajë. Pikërisht falë virtyteve të kësaj race..., qeveria ime ia doli mbanë t’i sjellë stabilitet shtetit dhe të siguroje një administratë normale”. Krijimi i Ministrisë së Luftës, i Shtabit Madhor, i bazës ligjore e normative, krijimi i xhandarmërisë, mobilizimi në luftë i disa batalioneve redif e muztafëz, plus tri kompanive me nizamë shqiptare, krijimi i një kompani model të ushtrisë së rregullt, dhe nën shembullin e saj të tre batalioneve me ushtarë aktiv, dhe një grupi me 120 kalorës, a nuk përbënin këto një bërthamë të ushtrisë së rregullt, apo një ushtri të vogël në numër? Kjo veprimtari nuk mbeti vetëm në disa masa organizative paraprake. Ngritja e Ushtrisë së rregullt dhe asaj të përhershme ishin një nevojë e kohës, por ato nuk u realizuan sipas parashikimeve, për shkak të kushteve shumë të vështira në të cilat u detyrua të vepronte Qeveria, të mosnjohjes së saj nga përfaqësuesit e fuqive të mëdha si qeveri kombëtare e të ndërhyrjeve të tyre të padrejta. Qeveria e Vlorës vepronte në një territor të lirë, të çliruar dhe në kushte lufte me pushtues të egër. Ajo

nuk kish pse të vonohej, forcat ushtarake ishin një detyrë urgjente e kohës dhe ajo iu përgjigj asaj me sa mundësi pati. Ndërkohë duhet shënuar se batalionet me redifë dhe ato mustafëz, brenda territorit ku shtrinte veprimtarinë e saj Qeveria e Vlorës në fakt i përkisnin një ushtrie të rregullt, sepse ishin organizuar mbi bazën e ligjit ushtarak, me organika standard, për moshën e pjesëmarrësve, numrin e tyre, komandën, uniformën dhe armët që i mbanin në magazinat e ushtrisë etj. Fakti që nuk ishin forca aktive, të përhershme, d.m.th., nizamë, apo ushtarë aktiv, nuk i bën ato ushtri (forcë) e parregullt. Ato edhe sot janë pjesë e Forcave të armatosura në katër anët e Botës. Shto këtu dhe faktin që Qeveria kishte vendosur, më 13 janar 1913, dhe realizoi krijimin e armës së xhandarmërisë. Kujtojmë se xhandari i vitit 1913 ishte edhe ruajtës i rendit edhe ushtar i luftës, një forcë ende e pa diferencuar. Pra ishte pjesë e ushtrisë së rregullt. Prandaj edhe në përbërjen e Shtabit Madhor kishte një Komision të trajtimit të policisë dhe të xhandarmërisë. Diferencimi i kësaj arme, ndarja e xhandarmërisë nga policia dhe ushtria u bë më vonë, deri në vitin 1920. Krijimi i ushtrisë nga Qeveria e Ismail Qemalit është regjistruar edhe në raportet e dy oficerëve të huaj, kapitenit austriak Ulmansky dhe gjermanit Claner, të cilët, siç shkruan prof. as. dr. Marenglen Kasmi, të urdhëruar nga Shtabi i Përgjithshëm austro-hungarez, kryen një vizitë dyjavore në Shqipëri. Kapiteni Ulmansky vizitoi qytetet e Shkodrës, Lezhës, Durrësit, Tiranës dhe Pogradecit, ndërkohë që kapiteni Clanner vizitoi Shqipërinë ë Jugut. Raporti që ata hartuan mbi vizitën e tyre në Shqipëri është jo vetëm tepër i hollësishëm dhe të krijon bindjen e një analize të thellë dhe të kujdesshme për gjendjen e shoqërisë shqiptare në prag të ardhjes së Wiedit, si për situatën politike, ekonomike dhe ushtarake të Shqipërisë. Dy kapitenët në raportin e tyre shkruajnë : “Qeveria e Ismail Qemalit në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, ishte më e vecantë. Ajo konsiderohej si Qeveria zyrtare e Shqipërisë dhe mbante lidhje diplomatike me qeveritë europiane. Në të vërtetë ndikimi i saj shtrihej vetëm në qytetin e Vlorës dhe në territoret e afërta të qytetit. Qeveria, - shkruajnë autorët, - kishte xhandarmërinë e saj dhe, në ndryshim nga qeveritë e tjera lokale shqiptare, kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, (nënvizimi im. S.O) kishte një forcë ushtarake, me një ministri lufte si dhe një shtab madhor që drejtonte ushtrinë, e cila gjithsesi ishte në fazën e saj të formatimit”. Krahasuar me qeveritë e tjera lokale, ajo e Vlorës kishte të ardhurat më të mira si pasojë e vjeljes së taksave portuale... Brenda vendit mbizotëronte një farë qetësie e rregulli dhe të huajt mund të udhëtonin pa probleme. Po ashtu shërbimi postar dhe ai telegrafik funksiononte në të gjithë vendin. Ky raport i dy kapitenëve austro-hungarez e gjerman, nga dy vende të njohura për organizimin modern ushtarak në Europë, dhe përfundimi i tyre se Qeveria e përkohshme e Vlorës kishte krijuar edhe ushtrinë e saj, mendojmë se vlen shumë për çështjen që po trajtojmë dhe mund të themi se i vë kapak asaj. Ndërkohë nuk duhet të harrojmë se kjo ushtri nuk ishte një ushtri evidencash dhe rrogëtarësh, por një forcë që kish luftuar e luftonte në front për të ndalur përparimin e forcave, sidomos greke, për të pushtuar Vlorën e territore të tjera nën autoritetin e Qeverisë së Përkohëshme të Vlorës dhe që përkrahte, aq sa kishte mundësi, edhe me oficerë, armatim e municion, kryengritjen e Dibrës të shtatorit 1913.

2. Mehmet Pashë Dërralla, ministër i Luftës
3. Ali Shefqeti (Shkupi) kryetar i Shtabit Madhor
4. Xhelal Koprencka, zëvendësministër i Luftës
5. Shtabi Madhor 1913,
6. Kompania model 1913.
7. Ushtarë të ushtrisë shqiptare 1913.
8. Vula e Shtabit Madhor 1913.
9. Selia e parë e Ministrisë së Luftës në Kaninë në shtëpinë e Hamzarajve.



PROF. ASOC. DR. ZAHO GOLEMI

Në përkujtim të efektivit të RENEA-s, djalit trim të Labërisë, komandantit profesionist, oficerit Elham Elezaj (27.7.1969 -9.7.1998), dëshmorit të Atdheut, që ngeli krenari dhe frymëzim për brezat e organizatës së madhe të Policisë së Shtetit. Elham Sulejman Elezaj është shpallur me titullin e lartë “Dëshmor i Atdheut” me vendim nr.229 datë 13.4.1999, titull që në bazë të ligjit “Për statusin e Dëshmorit”, është njohur me vendim nr.15 datë 31.10.2003 të Komisionit Qendror të statusit “Dëshmor i Atdheut” pranë Ministrisë së Mbrojtjes, vendim që është shoqëruar me certifikatë dëshmor si dhe më flamurin “Familje Dëshmorit”.

Në rrënjët e origjinës së oficerit të Policisë së Shtetit

Në gjithë rrethin e miqve, shokëve e kolegëve, kur flasin për Elham Elezin, kujtojnë një djalë trim të guximshëm e profesionist të Policisë së Shtetit, një dëshmor të shpallur ligjërisht por me tiparet e plota të një heroji, krenarie dhe dinjiteti, një djalë që ka ngelur krenari brezash dhe frymëzim për vijuesit e misionit të shenjtë dhe fisnik të organizatës së madhe të Policisë së Shtetit. Elham Elezaj erdhi në jetë 46 vite më parë në fshatin Hysoverdhë të Vlorës, por që rrënjët e origjinës familjare i kishte në fshatin historik të Kallaratis. Ai erdhi në jetë në një familje me tradita atdhetare, që kishte bërë emër në fshat dhe në krahinë, në gjithë lumin e Vlorës.

Elham Elezi ishte lindur, më 27 korrik 1969, në Hysoverdhë të Vlorës, në një familje kallaratase. Arsimin fillor e kreu në shkollën “Dalan Mehmeti”, ndërsa arsimin tetëvjeçar e të mesëm të përgjithshëm, i kreu në shkollën “Eqerem Beqiri”, në lokalitetin e Kotës. Që në fëmijëri u edukua me frymën atdhetare e patriotike, sepse në oxhakun e tij familjar ka pasur shumë të rënë për lirinë dhe pavarësinë e Atdheut dhe gjaku i derdhur në themelet e pavdekësisë kombëtare është amanet në breza për shqiptarët. Nga të dhënat e burrave më të vjetër të krahinës që i flasin epokave dhe që kërkojnë të lidhin brezat me të vërtetat historike, “... një oxhak i njohur me rrënjë në Kallarat janë edhe ‘Elezajt’. Rrëzë malit të Bogonicës janë rrënojat e fshatit të djegur nga anadartët grekë të 1914-ës. Kjo trevë dhe fshatrat përreth i ka folur shekujve me gjuhën labërishte, kur e ka kërkuar historia edhe me gjuhën e armëve kundër çdo lloj pushtuesi. Në këto troje, dhe jo vetëm, përballja me pushtuesit, të qenit luftëtarë ishte detyrim për mbijetesë dhe zanat që trashëgohej nga rrënjët stërgjyshore”. Elezajt janë një fis i njohur jo vetëm në Kallarat, por kudo ku kanë qenë dhe që kanë lëvizur me bagëti dhe punë të tjera nëpër trevat labe dhe më gjerë. Nga ana tjetër sa herë e kërkonte situata luftarake rrëmbenin armët dhe bëheshin bashkë për mbijetesë, për amanetin e të parëve trupëzoheshin me lirinë. Elezajt merituan nderimin dhe respektin jo vetëm në fshat por dhe në krahinë dhe më gjerë. Ata kanë qenë bashkë në të gjitha luftërat për liri e pavarësi. Të parët e oxhakut “Elezaj” janë me emër e kanë luftuar për mbrojtjen e tyre, për të drejtat, kanë qenë pjesëmarrës në kryengritjet masive antitanzimat, më 1847 kundër pushtuesve osmanë, kanë dhënë kontribut në katër luftërat për mbrojtjen e kryeqendrës së jugut të Janinës, janë gjakosur në luftë me andartët e 1914-ës, në Luftën e Vlorës, që u bë masive e kombëtare, pasi morën pjesë 89 çeta luftëtarësh dhe bënë të mundur kthimin e truallit të pushtuar dhe mundësuan pavarësinë e dytë të Shqipërisë, më 1920-ën. Ndërkohë që Elezajt shkruan epope lavdie gjatë viteve të Luftës Antifashiste Nacionalçlirimtare, pasi dhanë gjak për lirinë e Atdheut. Në këtë truall lindi Elhami biri i Sulejman Çerem Elezi dhe Antigoni Izet Sheraj (nga Bolena, por rritur në Vajzë të Vlorës). Sulejmani dhe Antigoni krijuan një familje të madhe dhe të denjë,

EPOPEJA E ELEZAJVE

Nga Luftërat e Labërisë te Dëshmorit i Policisë së Shtetit



duke sjellë në jetë gjashtë fëmijë: Elhami, Leonardi, Albani, Miranda, Esmeralda dhe Shaipi. Elhami ishte gëzimi i parë, që shpejt u bë krah familjes dhe në moshën e burrërisë u martua me Elvira Biraku/Elezaj dhe sollën në jetë një vajzë, Sodorela Elham Elezaj që ka sot një djalë dhe një vajzë, Xhoel dhe Melodi (që janë nipi dhe mbesa e dëshmorit Elhami Elezaj).

Tre dëshmorë të Atdheut, të oxhakut të atdhetarisë “Elezaj”

Për të nderuar dëshmorin e policisë së shtetit Elham Elezaj morëm takim me babanë e tij Sulejmanin, pjesë e një familjeje me rrënjë dhe me degë atdhetarie, një familje me të shkuar patriotike nga gjyshi e stërgjyshi, nga rrënjët kallaratase me histori të madhe në trevën e lumit të Vlorës, por me histori të njohur në rang kombëtar, pasi lavdinë dhe krenarinë në të gjitha luftërat e shqiptarëve kundër pushtuesve “jua hiqte pragu”, sikurse gjithë Kaonisë/Labërisë.

Por luftërat kanë pasur edhe të rënë që gjakun nuk e kanë kursyer për Atdhe dhe kanë vaditur pemën e madhe të lirisë sonë kombëtare. Nga të dhënat e Sulejman Elezaj mësojmë edhe më tepër për rrënjët e kësaj familjeje të njohur në fshat dhe krahinë. Kështu, i lindur dhe rritur në një truall të ashpër gjeografik, por atdhetari Shuaip Mahmut Elezaj ishte martuar me Medhuri Neim Bocaj (Elezaj) nga fshati Ramicë. Të dhënat flasin se në fund të shekullit XIX dhe fillim të shekullit XX, ata sollën në jetë katër djem dhe një vajzë: Çerem, Zyber, Amdë, Nexhip dhe vajza Sulote (e cila u martua në Ramicë me Ali Brahim Bocaj dhe pati 7 fëmijë, ku djali i madh Myftar Ali Bocaj doli partizan dhe ngeli pishtar lirie dëshmor i LANÇ-it, pasi mbeti përjetësisht në betejën tek Qafa e Gjarpërit). Në Labëri dhe sot e kësaj dite për ato

vatra që kanë derdhur gjak për Atdheun në periudha të ndryshme thuhet, “shtëpi lufte”, nderohen, respektohen dhe u shprehet mirënjohje për brezat, pasi janë dhe mbeten ajka e atdhetarisë shqiptare.

Ndërkohë që të tre djemtë e Shaipit u përbashkuan me formacionet partizane, luftuan në të gjitha betejat e përgjakshme të BrVS “heroinë e Popullit”, dhe gjakun nuk e kursyen për lirinë e Atdheut. Kështu Zyberi, Amdë dhe Nexhip Shaip Elezaj, janë që të tre dëshmorë, ku në dokumentacion janë shënuar me mbiemrin “Shero” ose “Sheraj” edhe pse në fakt janë që të tre nga oxhaku “Elezaj”, nga kjo derë e rëndë emëndritur e Kallaratis historik, që pavarësisht se pasardhësit u vendosën edhe në Hysoverdhë, edhe më vonë në Kotë për disa vite, ata mbajtën lart origjinën stërgjyshërore të kallarataseve, që kanë një devizë edhe sot e kësaj dite: “Ec ngado po Kallaratin mos e harro!”. I biri i Çeremit, Sulejmani e mbajti lart emrin e të parëve, nderoi dhe respektoi gjakun e tre xhaxhallarëve dëshmorë të LANÇ-it, por që prej vitit 1998 edhe një copëz e shpirtit të tij derdhi gjakun për rend dhe siguri publike në vendin tonë, pasi djali i madh i tij Elhami ngeli përjetësisht në altarin e kombit shqiptar me emrin e madh “Dëshmor”, ku mirënjohja e brezave në vijimësi do të jetë e përjetshme. Nga të dhënat në departamentin e Dëshmorëve pranë MM, por edhe në librin zyrtar të MM-së, të publikuar me rastin e 100-vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar evidentohet: “Zyber Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarat më 1916, rënë më 1946 (BrVS) në Mavrovë, është shpallur Dëshmor i Atdheut, me vendim nr.2 datë 7.1.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Amdë (Hamdi) Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarat, më 1920 dhe rënë më 1944, në Mavrovë (BrVS), është shpallur Dëshmor i Atdheut, me vendim nr.209 datë 29.7.1979 të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës.

Nexhip Shaip Sheraj/Elezaj, kishte lindur në Kallarat, më 1923 dhe rënë më 1944 (BrVS) në Salari, është shpallur Dëshmor i Atdheut, me vendim nr.97 datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Sulote Shaip Elezaj (vajzë kallaratase) martuar me Ali Boçi nga fshati Vajzë solli në jetë shtatë fëmijë. Djali i madh i saj Myftar Ali Boçi, i lindur në Ramicë më 1922, ra dëshmor në betejën e njohur të Qafës së Gjarpërit gjatë LANÇ-it dhe është shpallur me titullin Dëshmor i Atdheut me vendim nr.97 datë 22.9.1972, të Komitetit Ekzekutiv të KP të rrethit të Vlorës. Nga dera partiotike e Elezajve ka të evidentuar edhe “Elham Sulejman Elezaj është lindur, më 27 korrik 1969, në Hysoverdhë (me origjinë nga Kallarat) ka rënë, më 9 korrik 1998, në Tiranë, shpallur me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut me vendim nr.229 datë 13.4.1999; ndërkohë që titulli “Dëshmor i Atdheut” është njohur me vendim nr.15 datë 31.10.2003 të Komisionit Qendror të Statusit Dëshmor i Atdheut pranë Ministrisë së Mbrojtjes në Tiranë.

Karrierë e shkurtër me operacione të shumta policore në përballje me krimin

Elham Sulejman Elezaj ishte dhe ngeli përjetësisht një oficer policie special trim i pashoq, ndër më të aftët profesionalisht, me guxim e zell të papërshkruar, djalë Labërie i paepur para vdekjes, i lindur për t’u sakrifikuar në emër të detyrës, shpërfillës para rrezikut, i shoqërueshëm me kolegët, me ndjeshmëri të lartë për hallet e brengat e tyre, që gëzonte respektin e dashurinë e të gjithë specialëve, policë e oficerë. Biri i fshatit Hysoverdhë me rrënjë

kallarataste ishte pasionant për automekanikën, duke u bërë mjeshtër zanatçi në guidimin e çdo lloj automjeti. Ai kishte zhvillim fizik shumë të mirë, ose sikurse i thonë në Labëri, “djalë mali”, pëlqente të luante futboll, ishte lab ëndërrimtar për të vijuar karrierën ushtarake. Dega ushtarake e Vlorës, nisur nga të dhënat familjare, por edhe kondicioni i fuqishëm fizik, e përzgjodhi Elham Elezaj duke e mobilizuar si ushtar në repartin e policisë nr. 324, i quajtur dhe “batalioni i sigurimit i Ministrisë së Punëve të Brendshme”.

Ai kreu me sukses shërbimin e detyrueshëm ushtarak/ policor dhe më tej shërbeu edhe si shofer aktiv edhe në shërbime. Miqtë e tij të ngushtë e kujtojnë për veprimin energjik në digaster, edhe ditën që u sulmua godina e klubit të këtij dikasteri, më 29.5.1991, kur me guxim diti të përballonte valën e demonstruesve, si dhe të bëhej mburojë e pronës shtetërore përballë atyre që kërkonin të shkatërronin objektin duke i vënë flakën. Një vit më vonë, në nëntor 1992, u pranua në repartin nr.88, caktuar “shofer trupe operacionale”, ka qenë pjesëtar në shumë operacione me shkallë të lartë vështirësie, ndër të cilët përmendim ndërhyrjet e tyre në Valbonë, Korçë, Vlorë, Shkodër dhe në të gjithë Shqipërinë. Më tej u caktua duke u përzgjedhur edhe në grupin e sigurimit të ministrit të Brendshëm.

Elhami ka përballuar rreziqe të shumta në jetë edhe kur ishte me shokë në një shërbim në segmentin ura e Bunës - ura e Bahçallëkut, në dhjetor 1993, kur një grup kriminal iu kundërpërgjigj me zjarr thirrjes së specialëve në një pikë kontrolli, të cilët iu vunë në ndjekje dhe plumbat goditën makinën e policisë, duke i këputur tubin e naftës dhe e detyruan të ndalej, çfarë ishte fat për grupin, duke mos mundur t’i dëmtonin. Për aftësi dhe zotësi meqënëse vendi pati probleme të mëdha me kanabizimin, në vitin 1994, kaloi në njësinë “antidrogë”, ku vijoi pa shpëputje nga puna edhe arsimin e lartë policor në Shkollën e Saukut, ku edhe u titullua “oficer policie” në vitin 1997. Në ngjarjet e periudhës 1996-1997 ka qenë shumë aktiv në shërbime speciale, përfshirë këtu pjesëmarrjen në lirimin e një politikani të marrë peng në Lushnjë, në janar 1997, në tentativat e dështuara të qeverisë për rivendosjen e rendit në Lushnjë; për nxjerrjen nga Vlora të punonjësve të plagosur të SHIK-ut, të cilët kishin mbetur të strehuar në Vlorë. Në rrjedhën intensive të jetës policore të asaj periudhe, Elhami u rikthye në “RENEA” në verën e vitit 1997. Ai u emërua në detyrën e komandantit të grupit të zhytjes, ndërkohë që profesionalizmi i tij ishte rritur dhe konsoliduar edhe me shërbime të shkallës së lartë dhe të jashtëzakonshme. Reparti i “RENEA-s”, në këtë periudhë pati një barrë të madhe në hapjen e akseve rrugore të bllokuara nga bandat kriminale në rritje, por dhe në mbështetjen e shërbimeve të policisë në të gjithë vendin për kapjen e elementëve të armatosur; ringritjen e komisariateve të Policisë të shkatërruar nga viti i mbrapshtë i 1997-tës për shkak të falimentimit të firmave piramidale. Rivendosja e rendit në rrethet problematike, shpartallimi i bandave që kishin uzurpuar portet, doganat, akset rrugore apo kishin vendosur hegjemoninë e tyre në terriore ku nuk guxonte të hynte asnjë shërbim policie, e bënte më së miri reparti ku bënte pjesë edhe Elhami. Ai ka qenë pjesë në shërbimet që ndërmorën specialët në Vlorë, që filloi më 10.8.1997, dhe tregoi trimëri, guxim e zotësi në goditjen e shpartallimin e bandës së Çoles, në goditjen e bandave të tjera, që mbanin emrin e krerëve të grupeve, ku përmendeshin “Gaxhai”, “Mukajt” apo “Xhelitët”, ishte pjesëmarrës në një operacion shumë të vështirë në Cërrik të Elbasanit në përballje me bandat, ku ka pasur edhe shumë humbje jetësh. Elham Elezaj në emër të detyrës gjithmonë i gatshëm në çdo aksion, ka treguar guxim të madh në të gjitha operacionet policore në të gjithë vendin. Janë për t’u përmendur veçanërisht operacionet e Policisë së Shtetit në veri të vendit e sidomos në shërbimet e kryera në Shkodër, në 18-21.1.1998, kur u rebeluan disa punonjës policie, kur u mor peng edhe prefekti Gëzim Podgorica dhe u plagosen specialët Genc Hoshafi dhe Sokol Shepeteja. Një nga ngjarjet më të veçanta është hyrja në Shkodër, duke zbritur me helikopter në kodrat e Tepes, kur u “zaptua e u djeg qyteti” nga njerëz me maska dhe Elhami ishte në krye të grupeve që krahëmorën kurrizit të kodrës së kalasë për rrethimin e kapjen e personave të armatosur, një veprim shumë i guximshëm dhe me rrezik të madh. Ndërsa sipas dëshmimeve të komandantit të tij Hilë Lushaku, veprimet energjike të grupit të tij në ngjarjet e datave 22 dhe 23.2.1998, në kodrën e Tepesë (edhe vetë fjala “tepe” do të thotë kodër), ishin

vendimtare në thyerjen e qëndresës së kriminelëve dhe lehtësimin e veprimeve të grupeve të tjera të Forcave Speciale e atyre të Ndërhyrjes së Shpejtë, që sulmonin përballë për kalimin e urës së Bahçallëkut. Grupet e guximshme të policisë kapërcyen me sukses edhe tetë pengesa xheniere të vendosura në këtë rajon si dhe të kombinuara edhe me ngarkesa me lëndë plasëse. Janë me dhjetëra veprimet e Policisë së Shtetit, ku Elhami ishte gjithmonë pjesë e dorës së fuqishme të shtetit për të rivendosur rendin dhe qetësinë publike në Shqipëri. Në këto veprime shumë gjak i policisë, gjak i shtetit u derdh për rend dhe qetësi publike.

Ngjarja që i mori jetën Elham Elezit ishte ajo kur në një ngjarje pengmarrjeje u bë aktivizimi i “RENEA-s” që mundësoi lirimin e shtatë pengjeve, pjesëtarë të një familjeje. Në këtë operacion mbeti i vrarë Elham Elezaj dhe u plagos special i Adhurim Ceka, si dhe u vra pengmarrësi, polic në repartin e ruajtjes së objekteve në Tiranë. Kështu ishte pikërisht mbasditja e datës 9.7.1998, kur në zonën e “Varrit të Babit”, Elhami humbi jetën tragjikisht në një operacion policor për kapjen e një personi të armatosur, që kërcënonte me jetë njerëzit e marrë peng.

Sikurse mësojmë nga ish-Komandanti i Repartit special Vasillaq Sota: komandant i repartit ka qenë Artan Didi, ndërsa në grupin e ndërhyrjes në ditën e aksionit ishin: Elham Elezi komandant njësie, Ardian Dibra, Vladimir Doko, Adhurim Ceka, i cili u plagos në këtë aksion. Pjesa tjetër e grupit ka qenë në kufizim. (Para transferimit te RENEA Elhami ka shërbyer për katër vite në një Repart Special (Rep spec 77 Tiranë) ose Antidroga 1994-1997, ku dallohej për trimëri zgjuarsi dhe itegritet. Në ditën e aksionit, ndërhyrja e Elhamit ishte fatale, pasi i mori jetën atij në lulen e rinisë, në kulmin e energjive, duke e shndërruar atë në të pavdekshëm, në legjendë dhe hero, duke ngelur në përjetësi në altarin e trimërisë e etiketuar, “komandant Elham Elezaj, trimi i vendosur dhe besnik, që mbrojt me gjakun e tij, me jetën e tij jetët e të tjerëve duke merituar mirënjohjen mbarëpopullore”. Ai ishte dhe mbeti një oficer policie shembullor, një polic i lindur i veshur me vetitë dhe virtytet më të larta njerëzore, një trim që si trembej syri kurrë, aq sa shokët e tij thoshin një maksimumë proverbiale labe me shaka: “këtë djalin lab se ha plumbi”. Por plumbi i pabesisë dhe i krimi ka marrë shumë jetë të organizatës së Policisë së Shtetit.

Elham Elezi kaloi me sukses të plotë operacionet më të vështira të viteve të mbrapshta 1997 dhe 1998, ndoshta vitet më të trazuara të shekullit në aspektin e brishtësisë së rendit dhe të sigurisë. Por ai humbi jetën në një operacion për ndalimin e një ish-policit të dehur dhe me probleme të mëdha. Shokët e tij të armës policore e kujtojnë vazhdimisht për mirësinë njerëzore që rrezatonte me shokët e kolegët, me vartësit që i kishte shokë besnik në çdo operacion, që realisht kanë qenë të shumta dhe me shkallë jashtëzakonisht të lartë rrezikshmërie. Si një repart elitar dhe me unitet mendimi dhe veprimi djemtë e RENEA-s, i bënë homazhe dhe e përcollën shokun e tyre, më 10 korrikun e 1998-tës, tek ish-SHQUP-i, buzë lumit Lana. Elham Elezaj ka qenë i martuar me Elvirën nga Skrapari si dhe ka lënë një vajzë, Sidorelën. Sidorela pas humbjes së babait dëshmor (ndërkohë që kanë kaluar 27 vite nga ajo kohë) ka sjellë në jetë një djalë dhe një vajzë, që janë nipi dhe mbesa e dëshmorit.

Elham Elezaj, ky djalë trim i specialëve, profesional me guxim e zell të madh, i paepur para vdekjes, i lindur për t’u sakrifikuar në emër të detyrës, shpërfillës i çdo rreziku, me ndjeshmëri të lartë për hallet e brengat shoqërore, gëzonte respektin e dashurinë e të gjithë specialëve, policë e oficerëve. Kështu që, pas rënies në krye të detyrës u preh për pak kohë në varrezat e Tufinës, por me shpalljen e tij me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut, vëndprehja e tij do të ndryshonte dhe do të vendosej ku kishte shokët, ku prehen dëshmorët e Atdheut. Kështu më 5 maj 2022, eshtrat e tij, së bashku me ato të Rifat Cukut e Rifan Hakramës, u varrosën me ceremoni zyrtare shtetërore në “Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut” në Tiranë. Djem si Elhami i dhanë emër dhe famë repartit special “RENEA”, (Reparti i Neutralizimit të Elementit të Armatosur), një repart mjaft i njohur në Shqipëri, për garancinë dhe sigurinë që ofron dhe për zgjidhjen e situatave më të vështira në vendin tonë. Për këtë flasin veprat, operacionet, të rënë dhe të gjitha këto duhen shkruar, pasi sikurse thotë një postulat i lashtë romak i gadishullit të apenineve: “verba volant, scripta manent” ,/(fjalët i merr era, e shkruara mbetet).

Vlerësimi për dëshmorët është vlerësim për nderin dhe lavdinë e shqiptarizmës

Shokët, miqtë e kolegët e Elhamit përbashkohen në mendime dhe vlerësime për shokun e tyre dëshmor,

kur thonë: “Respekte dhe vlerësimet më të larta për Elhamin, djalin lab me cilësi të veçanta, shok besnik dhe i shkëlqyer me virtyte besnikërie e trimërie, me guxim që vetëm heronjtë i kanë..”. Komandanti i tij Hilë Lushaku shkruan: “Dëshmori i Atdheut Elahm Elezi nuk nderohet në përvjetore (me dekorata), sikurse shumë të tjerë, kur nuk rekomandon ndonjë subjekt politik, me nismë nga lart, (pasi nuk ka qenë kurrë militant, ose nuk i ka bërë hije ndonjë Partie ..), por i ka shërbyer me dinjitet vetëm shtetit. Polikseni Shenaj/Danaj e shkreh vlerësimin e saj për dëshmorin e Atdheut në vargje: “Elham Elezaj, o trim i rrallë,/ Ti çdo herë në plan të parë,/ Djalë i fortë, zemër-luan,/ Ty Zoti të desh pranë./ U prefsh në paqe,/o ëngjëlli ynë!..”. Ndërsa poeti i policisë Besnik Meta, e përjetësoi dëshmorin Elham Elezaj në vargjet: “Malli më ka marrë”,/ Këpucët e tim biri,/ S’i shoh më tek dera,/ të lagura nga shiu,/ Të thara nga era./ Malli më ka marrë/ Sa më ka sflitur,/ Zemra flakëron/ Shpirti i zhuritur./ Në repart tek shokët,/ Bir, të ndjej pranë!/ Ata porsi prindi/ Të kujtojnë plot mall..”. Në librin zyrtar “Dëshmorët e Atdheut”, të publikuar nga Ministria e Mbrojtjes, më 2012-ën, në kuadër të 100-vjetorit të krijimit të shtetit shqiptar, në kapitullin “Dëshmorë të Atdheut të rënë në Tiranë pas vitit 1945”, në faqen 170 dokumentohet: “Elham Sulejman Elezaj është shpallur me titullin e lartë Dëshmor i Atdheut” me vendim nr.229, datë 13.4.1999, lindur më 27.7.1969 dhe rënë në krye të detyrës më 9.7.1998. Vendimi për dhënien e titullit “Dëshmor i Atdheut” i është dhënë pas nëntë muajsh e katër ditësh. Vlerësimet për dëshmorin kanë qenë të rralla edhe pse kontributi i tij në një jetë të shkurtër ka qenë i gjatë dhe sinjifikativ në detyrat më të vështira që ka përballuar Policia e Shtetit e veçanërisht reparti special i saj “RENEA”. Këtu është për t’u shënuar se Këshilli Bashkiak i Vlorës ka marrë në analizë dhe ka vlerësuar herë pas here edhe ata bij e bija të popullit që kanë shërbyer në Policinë e shtetit, por që kanë dhënë gjakun e tyre për mbrojtjen e rendit dhe të sigurisë së qytetarëve në Shqipëri. Kështu, pak kohë më parë, një rrugë në qytetin e Vlorës i është dhënë emri i oficerit të Policisë së Shtetit “Elham Sulejman Elezaj”.

Kështu shkruan gazeta “Shqiptarja”, 30.9.2025: “Një rrugë në qytetin e Vlorës merr emrin e Dëshmorit të Atdheut Elham Elezaj, ish-oficeri i RENEA-s, ra në krye të detyrës në moshën 29-vjeçare, më 9 korrik 1998. Është një rrugë, pranë stadiumit në Vlorë që do të mbajë emrin e dëshmorit të Atdheut, Elham Sulejman Elezaj. Në ceremoni morën pjesë përfaqësues të këshillit bashkiak të Vlorës, familjarë dhe ish-kolegët e Repartit RENEA. Suljeman Elezaj, babai i Dëshmorit të Atdheut Elham Elezaj, duke vlerësuar këtë nismë shprehej: “Biri im e dha jetën për Atdheun. Ne jemi familje që në të gjitha epokat kemi dhënë gjak për Atdheun. Kam tre xhaxhallarë dëshmorë të Luftës Nacionalçlirimtare dhe djali im është dëshmori i katërt në familjen tonë. Kemi dhënë shumë për atdheun. E ndjej veten krenar që emri i djalit do mbetet këtu në Vlorë ta nderojnë vlonjatët bashkë me ne familjarët”. Emërtimi i kësaj rruge, erdhi si propozim i këshilltarëve të djathtë dhe mori votat unanime në Këshillin Bashkiak të Vlorës. Në ditën e përirimit të rrugës me emër dëshmori, Elpiniqi Mërkuri, kryetare e këshillit bashkiak të Vlorës deklaronte: “Është një gjest i vogël por i vyer për komunitetin, për familjen. Qoftë i paharruar dhe e kujtofshim gjithmonë sa herë kalojmë në këtë rrugë, Dëshmorin Elham Sulejman Elezaj”. Kryesia e SHAK “Labëria” ka marrë në analizë të rënë për Atdheun por edhe ata që kanë rënë për vendosjen e rendit dhe sigurisë në vendin tonë dhe rrezulton se një ndër djemtë më të mirë të Labërisë mbetet përjetësisht në altarin e lirisë dhe të shqiptarizmës. Një grup intelektualësh nismëtar ka hartuar edhe procedurat e nderimit dhe të vlerësimit të figurave që meritojnë nderimin dhe nderimin e brezave dhe ka propozuar që ish-oficerit të RENEA-s, Elham Sulejman Elezaj (pas vdekjes), t’i jepet titulli “Nderi i Qarkut të Vlorës” me këtë motivacion: “Për kontribut sinjifikativ në mbrojtje të rendit dhe sigurisë publike, për shërbimin dinjitoz në repartin elitar RENEA në ringritjen e sigurisë së brendshme shqiptare, për angazhim serioz e profesional në gjithë operacionet policore në jug dhe në veri të vendit pas vitit të mbrapshtë të 1997-ës, duke lartësuar figurën e punonjësit të policisë nga treva vlonjate, për akte të shumta trimërie e guximi në mbrojtjen e rendit publik në Shqipëri, pa kursyer as jetën dhe gjakun e tij në mbrojtje të qytetarëve”. Biri i trevës fisnike vlonjate ishte dhe ngeli në kujtesën e të gjithëve si shembull guximi, trimërie e heroizmi, që nderohet në Vlorën e tij të dashur por dhe në mbarë vendin, në atdhetarinë dhe shqiptarizmen.

Veprimtaria e çetave patriotike në vitet 1900-1912



Prof. Asoc. Dr. BERNARD ZOTAJ

Çetat patriotike përbëjnë një nga faqet më të rëndësishme të historisë së lëvizjes kombëtare shqiptare në fillim të shekullit XX. Ato lindën si formacione të vogla luftarake në fshatrat e Shqipërisë dhe shërbyen si embrioni i rezistencës së armatosur që kulmoi me Shpalljen e Pavarësisë së Shqipërisë, më 28 nëntor 1912. Këto çeta ishin shprehje e organizimit popullor, vetëmbrojtjes dhe ndërgjegjes kombëtare në rritje, duke u shfaqur si vazhdimësi e traditës luftarake të periudhës së Rilindjes Kombëtare, që nga koha e Lidhjes Shqiptare të Prizrenit.



Roli i çetave në prag të Pavarësisë

Në jug të vendit, çetat e udhëhequra nga figura të shquara si Bajo e Çerçiz Topulli, Mihal Grameno, Themistokli Gërmenji, Kajo Babjeni, Sali Butka, Spiro Bellkameni e të tjerë, u bënë bërthama kryesore e rezistencës kundër administratës osmane. Ato mobilizuan popullin, përhapën idetë e lirisë dhe ndihmuan në krijimin e një fryme të përbashkët kombëtare. Guximi, trimëria dhe sakrificat i afruan këta burra me popullin e thjeshtë, duke u kthyer në simbol të shpirtit të lirë shqiptar.

Komitetet kombëtare dhe organizimi i çetave

Në nëntor të vitit 1905, me iniciativën e Bajo Topullit, u krijua në Manastir Komiteti i Fshtë të "Për lirinë e Shqipërisë", me qëllim të ngritjes së vetëdijes kombëtare dhe organizimit të luftës së armatosur. Bajo Topulli e konsideronte të domosdoshme që shqiptarët të mos prisnin lirinë, por ta fitonin atë me armë në dorë. Krijimi i çetës së parë në jug, në janar 1906, shënoi fillimin e një etape të re në lëvizjen kombëtare. Çerçiz Topulli, luftëtari i pathyeshëm, u bë figura më e spikatur e kësaj çete dhe një udhëheqës i njohur popullor.

Puna e tyre ndikoi në daljen e një numri të madh çetash të reja patriotike në të gjithë jugun, përfshirë ato të Sali Butkës, Qamil Panaritit, Spiro Bellkamenit, Themistokli Gërmenjit, Muharrem Rushitit, Demo Eminit etj.

Çetat e Labërisë dhe miqësia Topulli-Vranisht

Në fund të vitit 1908, një grup burrash të Labërisë – Ibrahim Abdullau, Alem Mehmeti, Zigur Lelo, Zaçe Xhelo, Laze Malo, Murat Tërbaçi, Selam Abazi, Azem Sulo e Sali Vranishti – u bashkuan rreth ideve të Çerçiz Topullit për organizimin e çetave në krahinë. Pikërisht atë vit, Sali Vranishti, trim i arratisur nga kalaja e Janinës, krijoi çetën e famshme të "Firarëve të kapedan Saliut", e përbërë nga luftëtarë nga Vranishti, Kallarati, Smokthina, Tërbaçi, Brataj e Kanina.

Miqësia midis Çerçiz Topullit dhe Sali Vranishtit u farkëtua në betejat dhe sakrificat të përbashkëta.

Kryeneçësia dhe vendosmëria e tyre, shpeshherë përballë forcave shumëfish më të mëdha osmane, ngjalli frikë te autoritetet e kohës, të cilat organizuan vazhdimisht ekspedita ndëshkimore.

Sali Butka dhe kolonjarët – figura qendrore e viteve 1910-1912

Në vitin 1910, Sali Butka, i shoqëruar nga rreth 2.500 kolonjarë, mori pjesë në mitingun historik të alfabetit shqip në Korçë. Mihal Grameno shkruante se

"kolonjarët çuditën botën me taktikën e tyre", duke nënvizuar disiplinën dhe seriozitetin e kësaj çete.

Butka ishte ndër firmëtarët e protestës kundër Portës së Lartë për ndalimin e shkronjave shqipe dhe u bë figura kryesore e Komitetit Kryengritës të Kolonjës në vitin 1911, së bashku me Myftar Butkën dhe Ganiun, të birin. Çetat e tyre shënuan një rol kyç në zgjerimin e kryengritjes kombëtare.

Spiro Bellkameni dhe zgjerimi i luftës

Kthimi i patriotit Spiro Bellkameni në vitin 1911 i dha lëvizjes një shtysë të re. Në bashkëpunim me Butkën dhe luftëtarë të tjerë, Bellkameni krijoi një çetë të re në Fushë të Korçës, e cila u shqua në betejën e Orman-Çifligut, ku ra një pjesë e luftëtarëve, sot të nderuar si dëshmorë të atdheut.

Kryengritja e vitit 1912 dhe çlirimi i jugut

Në maj të vitit 1912, Sali Butka mori pjesë në Kuvendin e Pejës, ku u vendos fillimi i kryengritjes së përgjithshme kundër sundimit osman. Pas kthimit në Kolonjë, ai organizoi mbledhjen historike të Frashërit, ku u mbledhën pothuajse të gjithë udhëheqësit kryesorë të Jugut.

Udhëtimi drejt Frashërit u pagëzua me gjak. Në Rrungajë, çeta ra në pritë dhe u vra Iljaz Butka, djali i dytë i Saliut. Humbja rëndoi zemrat e kolonjarëve, por nuk e ndali rrugën e tyre. Duke i bashkuar forcat kryengritëse të Jugut, Butka çliroi Ersekën dhe, në gusht të vitit 1912, Korçën - së bashku me çetat e Spiro Bellkamenit dhe Kajo Babjenit.

Gazeta "Koha", më 19 gusht 1912, shkruante: "Në ballë të çetës së dytë ishte kapedani i Shqipërisë, trimi i dëgjuar Sali Butka, burrë i thjeshtë e me gjithë zemër

mëmëdhetar".

Pas shpalljes së Pavarësisë, Butka mori detyrën për mbrojtjen e krahinave të jugut dhe Qeverisë së Vlorës nga sulmet e andartëve grekë dhe trupave të Xhavit Pashës. Gazeta "Liri e Shqipërisë" e cilësonte: "Si një luftëtar që po tregon trimërinë e tij si në kohë të Skënderbeut".

Veshja dhe armatimi i çetave

Luftëtarët e çetave patriotike identifikoheshin jo vetëm nga shpirtërimi i tyre, por edhe nga veshja karakteristike. Ata mbanin kryesisht kostumet tradicionale të krahinave përkatëse, shpesh të kombinuara me elemente të uniformave të vjetra osmane apo europiane, sipas mundësive dhe burimeve që gjenin.

Armatimi ishte i larmishëm. Përdoroheshin: Pistoleta të ndryshme, me çark të shek. XIX, revolverë "Ekzalia" me 2-8 tyta, "Mauser" 7.63 mm, modele austro-hungareze Rast & Gasser M1898; Pushkë: "Karajfilet" e famshme të Shkodrës, armë të përdorura dikur nga Ali Pashë Tepelena, mushketo të prodhimit amerikan, modele artizanale shqiptare të shek. XIX, pushkë "Shabi" të Shkodrës dhe "Mauser"-at e prodhimit osman të vitit 1911.

Këto armë, megjithëse të thjeshta, ishin të mjaftueshme në duart e luftëtarëve të stërvitur e të vendosur, të cilët mbetën besnikë deri në fund kauzës së lirisë.

Duhet të theksojmë se lufta e armatosur nuk ishte tipike për popullin tonë. Shumë shqiptarë gjatë kësaj lufte u organizuan në çeta dhe u vunë nën influencën e pushtuesve europianë, nën komandën e rreshtimit organik të njësive të tyre. Kjo ndodhi për arsye se shumë prej tyre, kryetarë e komandantë mendonin realizmin e aspirateve kombëtare nën këtë apo atë shtet.

Nga literatura e shteteve fqinjë është spekuluar shumë me këtë problem, duke i konsideruar shqiptarët dhe inkuadrimit të tyre si "banda pa ideale" në shërbim të atij që i "paguante" më mirë. Është e rëndësishme të theksohet se asnjë komandant i çetave nuk u lidh me ushtritë e vendeve fqinje, megjithëse monarkitë u prematuan atyre shuma të majme. I vetmi që bëri një gjë të tillë ishte Esat Pashë Toptani.

Historiografia ushtarake shqiptare, për vendin dhe rolin e çetave kryengritëse në këtë periudhë më tepër dhe më mirë duhej ta kishte organizuar dhe thënë fjalën e saj. Falënderojmë Muzeun e Forcave të Armatosura që në kuadrin e festave të nëntorit 2025, na mundësoi të shikojmë veprimtarinë e këtyre çetave që vepruan në këtë Luftë të Madhe.

NEXHBEDIN BASHA,
MAJOR NË REZERVË

Pak emra në historinë shqiptare përfaqësojnë guximin, vendosmërinë dhe dashurinë për atdheun si Mehmet Pashë Dërralla. Ai lindi në Gradec, pranë Tetovës, një zonë e njohur për traditat patriotike. Sipas disa biografive dhe burimeve dytësore, viti i lindjes mund të ketë qenë 1843, megjithëse nuk është gjetur një akt lindjeje publikisht i verifikuar. Arsimin fillor e kreu në vendlindje, ndërsa atë të mesëm në Shkup, qytet ku zhvilloheshin aktivitetet kulturore dhe politike shqiptare të kohës.

Pas shkollimit bazë, Mehmet Pashë Dërralla ndoqi studimet e larta ushtarake në Akademinë e Stambollit, ku u dallua për rezultate të shkëlqyera dhe aftësi organizative të jashtëzakonshme. Pas diplomimit, shërbeu në regjimente osmane në Anadoll dhe më pas ndoqi Shkollën e Lartë të Shtatmadhorisë në Stamboll, duke fituar titullin “Pasha”, ekuivalent i gradës së Gjeneralit.

Hyrja në histori: 4 dhjetor 1912

Më 4 dhjetor 1912, Mehmet Pashë Dërrallës iu besua detyra më e shenjtë dhe më jetike për vendin: udhëheqja e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare si Ministri i Parë i Luftës në qeverinë e Ismail Qemalit. Në këtë ditë, që sot mbush 113 vjet, ai krijoi institucionin që do të mbronte territorin, pavarësinë dhe identitetin e Shqipërisë.

Ky emërim nuk ishte rastësor. Mehmet Pashë Dërralla kishte përgatitjen, autoritetin dhe besimin e popullit dhe elitës patriotike. Jeta e tij ishte një udhë e gjatë nga garnizonet osmane deri te kryengritjet për liri, nga Lidhja e Prizrenit deri te betejat për mbrojtjen e trojeve shqiptare.

Si Ministri i Parë i Luftës, ai nisi menjëherë organizimin e Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, duke vendosur strukturat e para të komandës, regjimentet dhe detyrat e reparteve. Ai krijoi Shtabin e Madhor, organin qendror të planifikimit ushtarak, dhe vendosi rregulla disipline dhe mobilizimi për vullnetarët dhe ushtarët e paguar. Për të asistuar në këtë organizim, Mehmet Pashë Dërralla emëroi Ali Shefqetin si Shef të Shtabit të Ushtrisë, një rol kyç që garantonte koordinimin e operacioneve, planifikimin e lëvizjeve dhe mbajtjen e rendit brenda forcave të reja.

Nën drejtimin e tyre, Ushtria Kombëtare u përqendrua në mbrojtjen e vijave kufitare, ngritjen e kazermave dhe formimin e një strukture hierarkike që të mund të funksiononte si një ushtri moderne. Përveç këtij organizimi, Mehmet Pashë Dërralla dhe Ali Shefqeti punuan ngushtë me komandantët lokalë në gjithë hapësirën shqiptare, nga Shkupi e Tetova deri në Vlorë, duke përfshirë edhe zonat e Kosovës dhe të Maqedonisë së sotme.

Ky proces nuk ishte thjesht ushtarak, por edhe politik: Ushtria Kombëtare u bë një simbol i pavarësisë dhe unitetit shqiptar, ndërsa Mehmet Pashë Dërralla shfaqti aftësi të rralla strategjike dhe diplomatike për të bashkuar luftëtarët nga zona të ndryshme. Ai nuk ishte thjesht komandant, por krijuesi i një ushtrie që do të mbronte Shqipërinë e re, duke lënë gjurmë që do të kujtoheshin për breza.

4 dhjetor 1912 - 4 dhjetor 2025, Forcat e Armatosura, 113 Vjet Ushtri Kombëtare Shqiptare

MEHMET DËRRALLA: MINISTRI I PARË I LUFTËS,
KRIJUESI I USHTRISË SONË KOMBËTARE

Aktiviteti patriotik dhe Lidhja e Prizrenit

Bruga e tij u lidh ngushtë me Lidhjen Shqiptare të Prizrenit, që synonte mbrojtjen e trojeve shqiptare dhe të drejtave të kombit në periudhën osmane. Si oficer i garnizoneve osmane në Kosovë, ai shërbeu në qarkun e Prizrenit, që përfshinte Tetovën, Gjakovën, Lumën dhe Shkupin.

Në këto detyra, Dërralla zhvilloi një rol strategjik, duke mbajtur rendin dhe duke ndihmuar në organizimin e kryengritjeve të viteve 1910–1912 kundër përpjekjeve serbo-malazeze për të pushtuar territorin shqiptar.

Ai bashkëpunoi me personalitete të shquara të Lidhjes së Prizrenit, si:

Abdyl Frashëri, Ymer Prizreni, Sylejman Vokshi, Ali Pashë Gucia, Haxhi Zeka, Idriz Seferi, Isa Boletini, Halim Deralla, Selim Reka, Riza bej Gjakova dhe shumë të tjerë.

Me përvojën e tij osmane dhe formimin e lartë ushtarak, Mehmet Pashë Dërrallës iu besuan përgjegjësi për mbrojtjen e interesave kombëtare dhe koordinimin e luftëtarëve shqiptarë në Kosovë dhe Maqedoni. Ai u bë një figurë kyçe për organizimin e forcave patriotike dhe ngritjen e strukturave të para të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare.

Shpallja e Pavarësisë dhe Ministri i Parë i Luftës

Si firmëtar i Pavarësisë, Mehmet Pashë Dërralla përfaqësonte Shkupin dhe Tetovën. Në detyrën e tij, ai

hodhi themelet e organizimit të Ushtrisë Kombëtare Shqiptare, krijoi strukturat e armëve dhe shërbimeve, si dhe promovoi mobilizimin e ushtarëve vullnetarë dhe të paguar.

Bashkë me Major Ali Hysen Shefqeti (Shkupi), ai ngriti Shtabin e Madhor të Ushtrisë dhe xhandarmërinë e parë. Nën komandën e tij, luftëtarët shqiptarë i rezistuan sulmeve serbo-malazeze dhe mbrojtën hapësirën ndërmjet Drinit të Bardhë dhe Drinit të Zi.

Trashëgimia dhe martirizimi

Pas dorëheqjes së qeverisë së Ismail Qemalit, në janar 1914, dhe pushtimit të përkohshëm nga Komisioni Ndërkombëtar i Kontrollit, Mehmet Pashë Dërralla u la në hije, ndërsa familja e tij u përndoq dhe u shpërnda në Pejë dhe në Shqipëri. Por figurës së tij nuk mund t'i shuhet epika: ai mbeti nacionalist, strateg dhe udhëheqës i lëvizjeve për çlirim e bashkim kombëtar.

**Poezi: “Zemra më rreh me puthë ato sokola”
Kushtuar Mehmet Pashë Dërrallës,
Ministër i Parë i Luftës,
i Qeverisë së Ismail Qemalit**

*Prej Prizreni vjen haberi,
Pash Dërralla trim me nam,
Nga Stambolli fluturoi si shqipe,
Plagë në zemër shteti amë...*

*Fjala n'kuvend i kish nur,
Flamuri i kombit Amanet,
N'istikame qëndroi si burrë,
Kurrë s'u tut për kombin e vet.*

*Nga Helepi në Bagdad,
Luftoi si Pasha turk,
Erdh n'atdhe me puthë ato sokola,
Gradat hoqi me trimat u nis në luftë.*

*Pash Dërralla legjendë e gjallë,
Luftoi nga istikami n'istikam,
Tetovari me pushkë si strall,
Ballë për ballë me krah e shkja.*

*Si strateg e politikan,
Fjala shpatë e zemra zjarr,
Në rrënjë me zemër ilirian,
Me shpirt t'pastër e qelibar.*

*Fluturoi në Vlorë, si vetëtimë,
Me puthë flamurin Kuq e Zi,
Si firmëtar u betua për Pavarësinë,
Nga hiri e ngriti ushtrinë...*

*Gjumi iu trazua, iu trazua,
Birit të Pejës, trim i rrallë,
Si zog shtegtar u përndoq në gen,
Demonët të persekutuan për liri e fjalë.*

*Por, dielli lindi në demokraci.
N'varg t'poetit rri si gjeneral...
Si Ministër i Luftës gjurmë la n'histori,
Iu bë krah Ismail Qemalit për vatan*

Pasojat Afatgjata të COVID-19 dhe Efektet e Vaksinave: Një Perspektivë Shëndetësore

Pandemia e COVID-19 ka qenë një nga ngjarjet më të mëdha shëndetësore të shekullit XXI, duke prekur miliona njerëz në mbarë botën dhe duke lënë pasojat afatgjata në shëndetin e individëve. Përveç rrezikut të menjëhershëm të infeksionit, virusi ka sjellë komplikacione të shumta kardiovaskulare, neurologjike dhe psikologjike. Në këtë kontekst, vaksinat kundër COVID-19 u shfaqën si mjeti kryesor për të frenuar pandeminë dhe për të shpëtuar jetë. Megjithatë, përdorimi i tyre ka hapur debate të gjera, sidomos mbi efektet anësore tek të rinjtë, ku janë raportuar raste të rralla të inflamacionit të zemrës dhe, në disa raste, infarkte.

Pasojat e COVID-19 në shëndetin e njeriut

COVID-19 nuk është thjesht një sëmundje respiratore. Studimet kanë treguar se virusi prek sistemin kardiovaskular, duke rritur ndjeshëm rrezikun për infarkte, tromboza dhe komplikacione të zemrës edhe tek individët e rinj dhe pa sëmundje të mëparshme. Mekanizmi kryesor lidhet me inflamacionin e përgjithshëm që virusi shkakton në organizëm, i cili dëmton enët e gjakut dhe rrit koagulimin. Përveç kësaj, COVID-19 ka lënë gjurmë afatgjata në formën e “Long COVID”, ku individët përjetojnë lodhje kronike, dhimbje muskujsh, probleme me kujtesën dhe vështirësi në përqendrim për muaj të tërë. Këto pasojat kanë kufizuar ndjeshëm jetën e përditshme dhe kanë shtuar barrën mbi sistemet shëndetësore.

Efektet e vaksinave kundër COVID-19

Vaksinat kanë qenë vendimtare për të ulur numrin e vdekjeve dhe për të reduktuar format e rënda të sëmundjes. Organizata Botërore e Shëndetësisë ka deklaruar se ato kanë shpëtuar miliona jetë dhe mbeten një mjet thelbësor për mbrojtjen e shëndetit publik. Efektet anësore më të zakonshme janë të lehta dhe kalimtare: dhimbje në vendin e injektimit, temperaturë e lehtë, lodhje apo dhimbje koke. Megjithatë, studime të mëdha kanë dokumentuar raste të rralla të komplikacioneve serioze, si miokarditi dhe perikarditi, sidomos tek meshkujt e rinj nën 30 vjeç. Këto raste shfaqen zakonisht brenda dy javëve pas vaksinimit dhe, në shumicën e rasteve, kalojnë pa pasojat afatgjata me trajtim mjekësor. Infeksioni me COVID-19 vetë rrit ndjeshëm rrezikun për komplikacione kardiake.

Krahasimi i rrezikut mes COVID-19 dhe vaksinave

Kur analizojmë balancën mes rrezikut dhe përfitimit, është e qartë se COVID-19 është burimi kryesor i dëmeve shëndetësore. Virusit ka shkaktoar miliona vdekje dhe ka lënë gjurmë afatgjata tek të mbijetuarit, përfshirë komplikacione të zemrës dhe infarkte tek të rinjtë. Vaksinat, megjithëse nuk janë pa efekte anësore, kanë shpëtuar jetë dhe kanë ulur ndjeshëm rrezikun e formave të rënda të sëmundjes. Rastet e miokarditit pas vaksinimit janë të rralla dhe të menaxhueshme, ndërsa rreziku i infarkteve nga COVID-19 është shumë më i lartë. Në këtë kuptim, vaksinat nuk duhet parë si burim i rrezikut, por si një mbrojtje që redukton ndjeshëm pasojat e virusit.


COVID-19 ka lënë gjurmë të thella në shëndetin global, duke krijuar një gjeneratë pacientësh me komplikacione afatgjata. Vaksinat kanë qenë mjeti më i fuqishëm për të shpëtuar jetë dhe për të ulur barrën e pandemisë. Analiza e të dhënave tregon qartë se rreziku i infarkteve dhe komplikacioneve të zemrës është shumë më i lartë nga vetë COVID-19 sesa nga vaksinat.

Por megjithatë, studimet e fundit nga OBSH kanë treguar që pasojat e vaksinave nuk kanë qenë të vogla.

Studimet e fundit mbi vaksinat COVID-19 kanë identifikuar disa efekte anësore të rralla, kryesisht të lidhura me zemrën, gjakun dhe sistemin nervor.

Artikuj të kohëve të fundit mbi efektet negative

• ScienceAlert (Shkurt 2024): Një studim global mbi gati 100 milion persona të vaksinuar identifikoi lidhje të vogla midis vaksinave COVID-19 dhe disa gjendjeve shëndetësore që prekin trurin, gjakun dhe zemrën. Autorët theksojnë se rreziku është shumë i ulët dhe vaksinat mbrojnë fuqishëm kundër sëmundjes së rëndë ScienceAlert.



• FactCheck.org (Shkurt 2024): Një analizë ndërkombëtare mbi 99 milion persona konfirmoi efektet anësore të njohura, si miokarditi i rrallë pas vaksinave mRNA. U identifikua edhe një lidhje e mundshme midis dozës së parë të Moderna-s dhe një gjendjeje neurologjike të rrallë. Artikulli thekson se këto raste janë shumë të pakta krahasuar me numrin e madh të dozave të administruara FactCheck.org.

• Frontiers in Public Health (2025): Një studim mbi popullatën në Pakistan analizoi efektet anësore dhe pranimin e vaksinave COVID-19. U vu re se efektet anësore, edhe pse kryesisht të lehta, ndikojnë në hezitimin e njerëzve për t'u vaksinuar Frontiers. Efektet më të përmendura: miokarditi/perikarditi (inflamacion i zemrës), probleme të rralla neurologjike, dhe reaksione të lehta si lodhje, dhimbje koke, temperaturë.



Teknologjia Ushtarake dhe Balanca e Fuqisë Globale

Në dekadat e fundit, teknologjia ushtarake ka përjetuar një transformim të thellë. Përparimet në shkencë, inxhinieri dhe inteligjencë artificiale kanë ndryshuar mënyrën se si shtetet e fuqishme e konceptojnë mbrojtjen dhe operacionet luftarake. Nga raketat hipersonike e deri tek sistemet kibernetike, çdo zhvillim i ri ka sjellë një dimension të ri në fushën e sigurisë globale. Ky shkrim synon të analizojë fushat kryesore të inovacionit, pajisjet moderne të mbrojtjes dhe ndikimin strategjik që këto teknologji kanë në ekuilibrat ndërkombëtarë.

Armët hipersonike – epoka e shpejtësisë së pakapshme

Një nga zhvillimet më të bujshme është krijimi i raketave hipersonike. Këto armë lëvizin me shpejtësi mbi pesë herë më të madhe se ajo e zërit, duke e bërë pothuajse të pamundur interceptimin e tyre nga sistemet tradicionale të mbrojtjes ajrore. Përveç shpejtësisë, ato kanë aftësi manovruese të larta, gjë që i lejon të shmangin radarët dhe mbrojtjet ekzistuese. Fuqitë e mëdha po investojnë miliarda për t'i zhvilluar, pasi ato përfaqësojnë një avantazh strategjik të jashtëzakonshëm.

Dronët dhe sistemet pa pilot – syri dhe krahu i ri i ushtrisë

Dronët janë kthyer në simbolin e luftës moderne. Fillimisht të përdorur për zbulim, sot ata kryejnë sulme precize, transport logjistik dhe operacione nën ujë. Kombinimi i dronëve me inteligjencën artificiale ka sjellë sisteme autonome që mund të veprojnë pa ndërhyrje të vazhdueshme njerëzore. Në fushëbetejë, kjo do të thotë më pak rrezik për ushtarët dhe më shumë efikasitet në operacione.

Lufta kibernetike – fronti i padukshëm

Në epokën digjitale, sulmet kibernetike janë bërë po aq të rrezikshme sa armët tradicionale. Shtetet investojnë në mbrojtje të avancuar për të ruajtur rrjetet ushtarake dhe infrastrukturën kritike. Një sulm i suksesshëm mund të paralizojë komunikimet, sistemet e energjisë apo logjistikën e një ushtrie. Kjo ka bërë që lufta kibernetike të konsiderohet si një front i ri, ku beteja zhvillohet pa plumba, por me kode dhe algoritme.

Inteligjencia artificiale, komandanti i padukshëm

AI po merr një rol gjithnjë e më të madh në ushtri. Ajo përdoret për analizën e të dhënave, vendimmarrje të shpejtë dhe kontrollin e sistemeve autonome. Përmes algoritmeve të avancuara, komandantët marrin informacione të përpunuara në kohë reale, duke u lejuar të reagojnë më shpejt ndaj kërcënimeve. Për më tepër, AI po përdoret në stërvitje përmes realitetit virtual, duke krijuar skenarë të ngjashëm me betejat e vërteta.

Teknologjitë satelitore dhe hapësinore, kontrolli nga lart

Satelitët ushtarakë janë bërë pjesë e pandashme e mbrojtjes moderne. Ata ofrojnë komunikim të sigurt, navigim të avancuar dhe zbulim në kohë reale. Përparimet e fundit përfshijnë satelitë më të vegjël, më të lirë dhe më fleksibël, të cilët mund të lëshohen në orbitë me shpejtësi. Kjo u jep ushtrive aftësi të monitorojnë çdo cep të globit dhe të koordinojnë operacionet pa ndërprerje.

Pajisjet e ushtarit modern, njeriu si platformë teknologjike

Ushitari i sotëm nuk është më thjesht një individ i armatosur, por një platformë teknologjike e integruar. Uniformat inteligjente përmbajnë sensorë biometrikë që monitorojnë gjendjen shëndetësore, komunikim të integruar dhe mbrojtje balistike të avancuar. Kjo e bën çdo ushtar pjesë të një rrjeti të gjallë, ku informacioni qarkullon në kohë reale dhe vendimet merren më shpejt.

Ndikimi strategjik – një botë në ndryshim

Zhvillimet teknologjike ushtarake po ndryshojnë ekuilibrat gjeopolitikë. Vendet që investojnë më shumë në inovacion fitojnë avantazh të dukshëm ndaj rivalëve. Përveç kësaj, shumë shpikje ushtarake kalojnë në përdorim civil, siç ndodhi me GPS-in dhe

internetin. Nga ana tjetër, teknologjitë civile si AI dhe robotika po përshtaten për mbrojtje, duke krijuar një ndërthurje të pandashme mes dy botëve. Konfliktet moderne janë gjithnjë e më hibride, duke kombinuar sulme fizike dhe kibernetike, çka e bën sigurinë globale më komplekse se kurrë.

Teknologjia ushtarake po evoluon me ritme marramendëse. Raketat hipersonike, dronët, inteligjencia artificiale dhe sistemet kibernetike janë vetëm fillimi i një epoke të re. Në këtë realitet, mbrojtja nuk është më thjesht çështje armësh tradicionale, por një kombinim i inovacionit shkencor, teknologjisë digjitale dhe strategjisë globale. Ushtria e së ardhmes do të jetë një simbiozë mes njeriut dhe makinerisë, ku efikasiteti, siguria dhe fuqia do të përcaktohen nga niveli i teknologjisë.





Forcat e Armatosura shqiptare festojnë

113

VJETORIN
E KRIJIMIT

GËZUAR!